Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje

Një manual

OSCE

2008

SI TË KËRKOJMË MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE:

Një manual për viktimat dhe organizatat jofitimprurëse

OSCE
2007

SI TË KËRKOJMË MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE:
Një manual për viktimat dhe organizatat jofitimprurëse
© Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2007.
Të gjitha të drejtat të rezervuara.

ISBN: 978-99943-993-5-2

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Organizatës për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë.

PËRMBAJTJE

Hyrje....6
Falenderime....8
Çfarë është dhuna në familje?....9
Cilët faktorë çojnë në dhunë në familje?....10
Cilat janë pasojat e dhunës në familje?....10
Kush mbrohet nga ligji?....11
Si mund të më mbrojë ligji mua nga dhuna në familje?....11
Ç'lloj mbrojtjeje mund të gjej?....12
Si mund të kem një urdhër mbrojtjeje?....14
A mund të kem mbrojtje edhe kur dal nga shtëpia?....14
Kush mund të kërkojë një urdhër mbrojtjeje?....14
Çfarë informacioni duhet të përfshij në kërkesë-padi?....15
Sa kohë duhet për të marrë një urdhër mbrojtjeje?....16
A më duhet të shkoj në gjykatë për të marrë një urdhër mbrojtjeje?....16
A mund t'i mbrojë urdhri i mbrojtjes fëmijët e mi?....17
A është e mundur që urdhri i mbrojtjes ta detyrojë dhunuesin të paguajë mbështetje financiare për viktimën ose fëmijën?....17
Nëse kërkoj një urdhër mbrojtjeje, a do të shkojë dhunuesi në burg?....17
Nëse marr një urdhër mbrojtjeje, a mund të nis edhe procedim penal kundër dhunuesit tim?....18
Çfarë mund të bëjë dhunuesi im kundër urdhrit të mbrojtjes?....18
Për sa kohë është i vlefshëm një urdhër mbrojtjeje?....19

A është urdhri i mbrojtjes i vlefshëm jashtë qytetit, komunës,
ose bashkisë ku jetoj unë?.....19
Nëse një urdhri mbrojtjeje po i mbaron afati, a mund të zgjatet?.....19
A mund të kërkoj ndihmë në lidhje me aplikimin për
një urdhër mbrojtjeje?.....19
Sa para do të më kushtojë kërkesa për një urdhër mbrojtjeje?.....20
Kur hyn në fuqi urdhri i mbrojtjes?.....20
Si mund të vërtetoj që jam viktimë e dhunës në familje?.....20
Çfarë provash mund të paraqiten në seancën dëgjimore gjyqësore?.....21
Kush mund të dëshmojë në seancë?.....21
Si mund ta ndryshoj ose ta anuloj urdhrin?.....22
Kush njoftohet për urdhrin e mbrojtjes?.....22
Çfarë duhet të bëj unë nëse dhunuesi thyen urdhrin e mbrojtjes?.....23
A do të më mbrojë mua një urdhër mbrojtjeje?.....24
A duhet t'i them punëdhënësit tim për urdhrin e
mbrojtjes apo për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes?.....24
Kujt tjetër mund t'i drejtohem për ndihmë dhe përkrahje?.....25

Shtojca

A. Listë e organizatave dhe strehave që punojnë me viktimat e dhunës në familje.....26
B. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".....30
C. Kërkesë-padi për lëshimin e urdhrit mbrojtës.....43
D. Kërkesë-padi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm mbrojtës.....48
E. Kërkesë për ndryshimin e një urdhri mbrojtjeje.....53
F. Rrota e pushtetit dhe kontrollit.....55
G. Llojet e abuzimit bashkëshortor.....56
H. Ditari i viktimës mbi abuzimin dhe ngacmimin.....57
I. Listë e gjërave që duhet të merrni me vete nëse largoheni nga shtëpia.....58

HYRJE

Dhuna në familje është një fenomen i përhapur në shoqërinë tonë. Ndodh mes partnerëve të ngushtë dhe ndodh në familje. Ndodh në të gjitha klasat shoqërore, pavarësisht moshës, arsimit, fesë, gjendjes ekonomike, etnisë, ose identitetit kulturor. Megjithëse mangësia e statistikave zyrtare e bën të vështirë për të pasur një panoramë të qartë të situatës, rreth 30% e grave shqiptare perceptojnë se janë viktima të kësaj forme abuzimi.[1]

Dhuna në familje është një sjellje e udhëhequr nga nevoja për të pasur kontroll. Mund të nisë nga kërcënimet, telefonatat bezdisëse dhe ndjekjet (si ndjekje e viktimës kur shkon e kthehet nga puna, dhe kërcënim), e deri tek marrëdhëniet seksuale të padëshiruara, goditjet, dhe në rastin më të keq, madje edhe deri në vdekje. Dhuna në familje zakonisht nuk është një rast i veçuar dhe shpesh bëhet më e ashpër dhe më e shpeshtë me kalimin e kohës. Shumë dhunues nuk janë të dhunshëm në marrëdhënie të tjera, si për shembull në punë ose me miqtë. Në mënyrë të përsëritur ata e mohojnë dhunën në familje dhe ashpërsinë e kësaj dhune. Kur ballafaqohen me sjelljen e tyre abuzive, ata kanë tendencën të fajësojnë partneren e tyre se i ka provokuar, ose refuzojnë të pranojnë përgjegjësinë.

Megjithëse ka një sërë faktorësh që çojnë në dhunë në familje, kjo gjithmonë është e lidhur me pabarazitë dhe çekuilibrin e pushtetit në marrëdhënie. Shpesh abuzuesi shpreh keqardhje, dhe ti dëshiron të besosh që abuzimi nuk do të ndodhë më. Por më pas, ndodh përsëri e përsëri. Ti do që të largohesh, por u druhesh pasojave. Dhuna përshkallëzohet nëse nuk ndërmerren masa për të ndryshuar situatën. Mos harro: cilatdo qofshin rrethanat, dhuna nuk është faji yt. Askush nuk meriton të abuzohet verbalisht apo fizikisht. Dhe megjithëse ligji nuk mund të të mbrojë krejtësisht nga dhuna në familje, mund të të ndihmojë që ti të mbrosh veten nga kjo dhunë.

1 "Dhuna bashkëshortore prek një ndër tre bashkëshorte shqiptare", e disponueshme në adresën: http:/www.newswise.com/articles/view/513263.

Në dhjetor 2006, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi një ligj të ri në ndihmë të viktimave të dhunës në familje, ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (ligji mbi dhunën në familje).

Qëllimi i ligjit është që të parandalojë dhe reduktojë dhunën në familje në të gjitha format e saj dhe të mbrojë viktimat e saj. Sipas këtij ligji, gjykatat civile mund të vendosin masa mbrojtjeje për viktimat përmes një procedure të shpejtë, të përballueshme dhe të thjeshtë. Ju mund të aplikoni për një urdhër mbrojtjeje ose për një urdhër mbrojtjeje të menjëhershëm ndaj abuzuesit tuaj pa pagesë dhe pa pasur nevojë për ndihmën e një avokati.

Megjithëse ligji tashmë është përforcuar dhe përcakton që dhuna në familje është e gabuar dhe kategorikisht e papranueshme, dhuna në familje ende mund të konsiderohet nga disa, fatkeqësisht, si një "çështje private familjare". Në raste të tilla, mos u dekurajoni dhe përgatituni për të këmbëngulur që të drejtat tuaja të respektohen. Ka njerëz që mund t'ju ndihmojnë.

Qëllimi i këtij manuali është që të shpjegojë se ç'lloj abuzimesh konsiderohen tani nga ligji si dhunë në familje, dhe si mund t'ju ndihmojë kjo juve që të mbroni veten nga lëndime të mëtejshme apo madje edhe nga vdekja duke i kërkuar gjykatësit që të lëshojë një urdhër mbrojtjeje ndaj dhunuesit tuaj. Shtojcat e manualit ju ofrojnë një listë me shërbime këshillimore dhe strehimore që ndihmojnë viktimat e dhunës në familje, dhe formularë të gatshëm që ju ose avokati juaj mund t'i përdorni për të kërkuar urdhër mbrojtjeje nga gjykata.

FALENDERIME

Ky manual u përgatit nga Maya Goldstein-Bolocan, Drejtuese e Projektit "Mundësitë e grave për t'iu drejtuar organeve të drejtësisë", zbatuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri. Frank Dalton dhe Dianne Post dhanë komente dhe sugjerime me vlerë. Emira Shkurti hartoi formularët e kërkesë-padive për lëshimin e urdhrit mbrojtës. Përktheu në shqip Sokol Bega, redaktoi Ama Kraja.

Për përgatitjen e këtij manuali janë këshilluar burimet e përmendura më poshtë:

USAID dhe OSBE, *Manuali i gjyqtarit shqiptar për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes* (botohet së shpejti).

Fletëpalosja e Shtetit të Kalifornisë, *A mund të më mbrojë ligji nga dhuna në familje?*,(2003) (Can the law help protect me from domestic violence?), i disponueshëm në:
http://www.calbar.ca.gov/state/calbar/calbar_generic.jsp?cid=10581&id=2181#1

Një listë faktesh nga Departamenti i Drejtësisë i Kanadasë, *Abuzimi Bashkëshortor –(Spousal Abuse: A Fact sheet from the Department of Justice Canada)*, i disponueshëm në:
http://www.justice.gc.ca/en/ps/fm/spouseafs.html

Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara, Zyra e Avokatit të Shteteve të Bashkuara, Rrethi i Kolumbisë, Njësia për asistencë ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, *Të Kuptojmë Dhunën në Familje: Një Manual për Viktimat dhe Profesionistët.*

ÇFARË ËSHTË DHUNA NË FAMILJE?

Ligji e përcakton dhunën në familje si çdo formë abuzimi e ushtruar nga një person ndaj një personi tjetër, e cila rezulton në dhunim të integritetit të tij fizik, moral, psikologjik, seksual, social ose ekonomik.

Abuzimi mund të ndodhë në çdo kohë gjatë një marrëdhënieje, përfshirë edhe kohën gjatë së cilës kjo marrëdhënie po mbaron, ose edhe pasi ajo ka përfunduar. Kjo lloj dhune nuk njeh asnjë mjedis kulturor, etnik, arsimor, apo ekonomik.

Partnerët abuzivë mund të përdorin një sërë taktikash të ndryshme në përpjekje për të ushtruar pushtet dhe kontroll mbi viktimat e tyre. Abuzimi mund të ndodhë një herë, ose mund të ndodhë me një model të përsëritur dhe të përshkallëzuar gjatë një periudhe prej muajsh apo vitesh. Me kalimin e kohës gjithashtu mund të ndërrojë edhe formë. Ka disa forma të ndryshme dhune në familje, dhe një person mund të jetë subjekt i më shumë se një forme.

Abuzimi fizik mund të konsistojë në një incident të vetëm ose mund të ndodhë në mënyrë të përsëritur. Përfshin përdorimin e forcës fizike në mënyrë të atillë që lëndon dikë – ose e më atë person në rrezik lëndimi – përfshirë rrahje, goditje, shkundje, shtyrje, mbytje, kafshime, djegie, shkelmime, ose sulme me armë. Forma të tjera të abuzimit fizik mund të përfshijnë izolim ose çdo përdorim tjetër të rrezikshëm apo të dëmshëm force ose shtrëngimi.

Abuzimi dhe shfrytëzimi seksual përfshijnë të gjitha format e agresionit seksual, ngacmimit seksual ose shfrytëzimit seksual. Të detyrosh dikë që të marrë pjesë në veprimtari seksuale të padëshiruar, të pasigurt ose degraduese, ose përdorimi i taktikave poshtëruese ose të tjera për të ulur, kontrolluar ose kufizuar seksualitetin e personave ose zgjedhjet e riprodhimit përbën abuzim seksual.

Abuzimi emocional përfshin sulme verbale, si bërtitje, këlthitje, fyerje (etiketime), izolim nga shoqëria, ose frikësim. Kanosje për dhunë dhe për marrje të fëmijëve janë taktika mjaft të përhapura të përdorura nga dhunuesit, si dhe dëmtimi i zotërimeve apo kafshëve të viktimës.

Abuzimi ekonomik ose financiar përfshin vjedhjen ose mashtrimin e

partnerit. Mosdhënia e parave që janë të domosdoshme për të blerë ushqim apo trajtim mjekësor, shfrytëzimi i një personi për përfitim financiar, mohimi i aksesit për burime financiare, ose pengimi i një partneri që të punojë janë gjithashtu forma të abuzimit ekonomik.

CILËT FAKTORË ÇOJNË NË DHUNË NË FAMILJE?

Dhuna në familje është një sjellje e udhëhequr nga nevoja për pushtet dhe kontroll. Megjithëse konsumimi i alkoolit dhe drogës nuk janë shkak për dhunë në familje, dehja apo të qenit nën efektin e drogës mund të intensifikojnë sjellje të dhunshme ekzistuese.

Megjithëse nuk ka shkaqe të drejtpërdrejta për abuzimin, studimet ndërkombëtare tregojnë se ka një sërë faktorësh që, të vetëm apo të kombinuar me të tjerë, shoqërohen me një rritje të rrezikut për abuzim. Disa nga faktorët e rrezikut përfshijnë:

- të qenit i ri;
- të pasurit një partner që pi shumë;
- abuzim emocional në marrëdhënie, që është një parashikues i rëndësishëm i dhunës fizike;
- ndarje martesore dhe divorc.

CILAT JANË PASOJAT E DHUNËS NË FAMILJE?

Abuzimi mund të prekë çdo aspekt të jetës së personit të abuzuar. Mund të cenojë shëndetin e tyre mendor dhe fizik, aftësinë për të punuar dhe për të fituar një pagë, dhe marrëdhëniet me fëmijët dhe të dashurit e tyre. Të qenit viktimë e abuzimit mund të shkatërrojë vetëvlerësimin dhe vetëbesimin e një personi. Në rastet më të këqija, të abuzuarit vriten nga abuzuesit e tyre ose shtyhen drejt vetëvrasjes.

Abuzimi gjithashtu shkatërron ata që nuk viktimizohen drejtpërdrejtë nga ai. Fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës në shtëpitë e tyre mund të kenë vështirësi serioze emocionale, zhvilluese, dhe në sjellje. Për shembull, ka më shumë mundësi që ata të bëhen adoleshentë dhe të rritur emocionalisht të paqëndrueshëm, agresivë dhe të dhunshëm.

Dhuna në familje gjithashtu ka efekte negative ekonomike për shoqërinë në tërësi. Këtu përfshihen shpenzime që kanë lidhje me proceset civile dhe penale, shpenzimet shëndetësore dhe mjekësore, reduktim i krahut të punës, dhe kosto të lidhura me shërbimet sociale.

KUSH MBROHET NGA LIGJI?

Ligji mbron një person mbi të cilin është ushtruar dhunë, e cila ndodh midis tij dhe personave që janë ose kanë qenë në lidhje familjare me të. Mbron gjithashtu pjesëtarë të tjerë të familjes së këtij personi ose të afërmit e tjerë të tij, kur ata vetë bëhen viktima të dhunës në familje. Sipas ligjit, anëtarë të familjes janë:

- bashkëshortët ose partnerët bashkëjetues, ose ish-bashkëshortë ose ish-partnerë bashkëjetues;
- vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar; fëmijët dhe bashkëshortët e këtyre personave;
- gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit dhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues;
- vëllezërit dhe motrat e bashkëshortëve nëse këta kanë jetuar bashkë gjatë 3 muajve të fundit;
- fëmijët e bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues;

SI MUND TË MË MBROJË LIGJI NGA DHUNA NË FAMILJE?

Sipas ligjit të ri mbi dhunën në familje, gjykatat civile mund të vendosin masa mbrojtëse për viktimat përmes një procedure të shpejtë, të përballueshme dhe të thjeshtë. Urdhrat e mbrojtjes ju japin juve mundësi për të marrë masa dhe për të mbrojtur veten nga dhuna. Ata mund t'ju sigurojnë lehtësim, duke e urdhëruar personin që ju ka abuzuar që të bëjë ose të mos bëjë gjëra të caktuara.

Ka dy lloje urdhrash mbrojtjeje:

Një **urdhër mbrojtjeje**: është një vendim gjykate dhe përcakton një sërë masash mbrojtëse për viktimën/viktimat e dhunës në familje. Gjykata lëshon urdhrin e mbrojtjes nëse gjen prova të mjaftueshme për të besuar se dhunuesi mund të kryejë një veprim dhune në familje ose kur lëshimi i

urdhrit të mbrojtjes është i domosdoshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e viktimës ose anëtarëve të familjes.

Një **urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje**: është një urdhër i përkohshëm gjykate i vlefshëm deri në lëshimin e një urdhri të rregullt mbrojtjeje. Mund të lëshohet nëse abuzuesi paraqet një "rrezik të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm ndaj sigurisë, shëndetit ose mirëqenies së viktimës ose anëtarëve të familjes së saj/tij". Gjykata ka vetëm 48 orë kohë për të marrë një vendim pas paraqitjes së një kërkese për këtë urdhër. Gjykata do të vendosë gjithashtu një datë për vazhdimin ose anulimin e urdhrit brenda 20 ditëve nga lëshimi i tij.

Të dy urdhrat hyjnë në fuqi menjëherë pas lëshimit nga gjykata dhe janë të vlefshëm pavarësisht faktit nëse abuzuesi është njoftuar ose jo.

Ç'LLOJ MBROJTJEJE MUND TË GJEJ?

Ekzistojnë një sërë mënyrash përmes të cilave mund t'ju mbrojë një urdhër mbrojtjeje.

Megjithëse lloji i mbrojtjes mund të luhatet në varësi të rrethanave individuale, një urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje mund të përfshijë një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

- urdhëron dhunuesin që të ndalojë së kryeri ose së kërcënuari se do të kryejë një akt të dhunës në familje kundër paditësit (viktimës) ose anëtarëve të tjerë të familjes të viktimës;
- detyron dhunuesin që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë ose të komunikojë drejtpërdrejt ose të tërthorazi me viktimën apo pjesëtar të familjes së viktimës;
- largon dhunuesin nga banesa për një afat kohor të caktuar me urdhër gjykate dhe e pengon të rihyjë në banesë pa autorizimin e gjykatës;
- pengon dhunuesin që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës;
- ndalon dhunuesin që t'i afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës ose banesës së ardhshme të çiftit ose banesës së personave të tjerë, dhe për më tepër shkollës së fëmijëve apo çdo

vendi tjetër të frekuentuar shpesh nga viktima, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;
- vendos viktimat dhe të miturit në qendra strehimi të përkohshme;
- kufizon ose ndalon dhunuesin që të takojë fëmijën e viktimës;
- ndalon dhunuesin që të hyjë ose qëndrojë në banesën e përkohshme ose të përhershme të viktimës, ose në çdo pjesë të banesës, pavarësisht nga të drejtat e zotërimit apo pronësisë që dhunuesi mund të ketë mbi këto objekte;
- urdhëron një person të autorizuar nga gjykata (polic ose përmbarues) që të shoqërojë viktimën ose dhunuesin në banesën e viktimës dhe të mbikëqyrë marrjen e sendeve personale;
- urdhëron punonjësit e policisë që të sekuestrojnë çdo armë në zotërim të dhunuesit dhe të gjetur gjatë kontrollove të policisë, ose urdhëron dhunuesin që të dorëzojë çdo armë në zotërim të tij ose të saj.

Përveç sa më sipër, një urdhër mbrojtjeje gjithashtu mund të:

- urdhërojë dhunuesin që të lejojë viktimën të zotërojë banesën në përdorim të përbashkët ose pjesë të saja;
- urdhërojë dhunuesin që të paguajë qiranë për banesën e përhershme ose të përkohshme të viktimës si dhe të paguajë detyrime financiare për viktimën, fëmijën, ose pjesëtarë të tjerë të familjes në ngarkim të viktimës;
- kalojë kujdesin e përkohshëm të fëmijëve te viktima dhe përkohësisht t'i heqë dhunuesit të drejtat prindërore;
- vendosë dhe urdhërojë ndërhyrjen e shërbimeve sociale publike ose private të vendbanimit ose të organizatave që kanë si qëllim mbështetjen dhe pritjen e personave të dhunuar në familje;
- urdhërojë dhunuesin që të kryejë një pagesë periodike në favor të personave bashkëjetues të cilët, si pasojë e masës së mësipërme mbeten të privuar nga mjetet e jetesës. Për të siguruar kryerjen e pagesës, gjykata mund të urdhërojë punëdhënësin e dhunuesit që ta transferojë pagesën drejtpërdrejt te përfituesi;
- dërgojë viktimën e dhunës në familje në programe rehabilitime;
- urdhërojë dhunuesin që të marrë pjesë në programe rehabilitimi.

SI MUND TË KEM NJË URDHËR MBROJTJEJE?

Nëse keni qenë subjekt i dhunës nga një anëtar i familjes ose nga dikush me të cilën jeni në një marrë-dhënie intime, mund të kërkoni një urdhër mbrojtjeje në ÇDO KOHË në ÇDO GJYKATË CIVILE (seksioni i familjes). Për ta bërë këtë, mund të shkoni në gjykatën e rrethit ku banoni (vendi i banesës së përhershme), edhe nëse jetoni atje përkohësisht (vendi i banesës së përkohshme), ose në gjykatën e vendit të banesës së përhershme ose të përkohshme të dhunuesit tuaj.

Orari i gjykatave të rrethit është nga e hëna në të premte, ora 08:00-16:00.

Nëse keni nevojë për ndihmë të menjëhershme, mund ta paraqisni kërkesën edhe në komisariatin më të afërt policor (të vendit të banesës apo kudo që të ndodheni), në njësinë tuaj të pushtetit vendor (bashki, komunë), ose në qendrën më të afërt të shëndetit publik. Policia më pas duhet të kontaktojë me gjykatësin në shërbim në mënyrë që ky i fundit të lëshojë një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje. Kur kërkesa paraqitet nga vetë policia ose prokurori, dëshira e viktimës për të tërhequr kërkesën nuk është e vlefshme, dhe procesi do të vazhdojë.

A MUND TË KEM MBROJTJE EDHE NËSE DAL NGA SHTËPIA?

Po. Urdhri i mbrojtjes dhe urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes janë të vlefshëm dhe të zbatueshëm në të gjithë Shqipërinë.

KUSH MUND TË KËRKOJË NJË URDHËR MBROJTJEJE?

Urdhri i mbrojtjes dhe urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes lëshohen pasi një kërkesë-padi (kërkesë me shkrim) paraqitet në gjykatë.

Kërkesa për urdhër mbrojtjeje mund të paraqitet nga:

- vetë viktima;
- përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
- policia/prokurori.

Nëse viktima është i mitur, kërkesën për urdhër mbrojtjeje në emrin e tij mund ta paraqesin:

- prindi ose kujdestari i tij;
- përfaqësuesi ligjor ose avokati i tij;
- të afërmit e tij;
- përfaqësues të zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktima, kur ata kanë dijeni mbi dhunën e shkaktuar;
- qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje të njohura/licencuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Kërkesa për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje mund të paraqitet nga:

- viktima;
- përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
- policia/prokurori;
- një pjesëtar i familjes së viktimës;
- përfaqësues të zyrës të shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku viktima ka banim të përhershëm apo të përkohshëm, të cilët kanë dijeni mbi incidentet e dhunës në familje që kanë ndodhur
- qendra dhe shërbime për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje të përmendura më lart.

ÇFARË INFORMACIONI DUHET TË PËRFSHIJ NË KËRKESË-PADI?

Një kërkesë-padi për urdhër mbrojtjeje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje duhet të përmbajë:

- emrin tuaj (kërkuesi) dhe të dhunuesit tuaj (i padituri);
- natyrën e kërkesës (faktin që po kërkoni një urdhër mbrojtjeje);
- lidhjen mes jush dhe dhunuesit (bashkëshortë, ish-bashkëshortë, nënë-bir, vjehërr-nuse);
- faktet (dhunën e ushtruar ndaj jush);
- pse keni frikë për mirëqenien tuaj;
- masat mbrojtëse të posaçme që po kërkoni;
- nënshkrimin tuaj (të kërkuesit).

Në shtojcat C, D dhe E, mund të gjeni formularë të gatshëm për të kërkuar urdhër mbrojtjeje, urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, si edhe modifikim për një urdhër mbrojtjeje.

SA KOHË DUHET PËR TË MARRË NJË URDHËR MBROJTJEJE?

Një kërkesë për urdhër mbrojtjeje mund të paraqitet në gjykatë në çdo kohë. Pasi paraqitet një kërkesë, gjykata ka 15 ditë kohë për të caktuar një seancë dëgjimore për të vendosur nëse do të lëshohet urdhri i mbrojtjes.

Kur paraqitet një kërkesë për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, gjykata vendos brenda 48 orësh. Nëse urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes lëshohet, gjykata duhet të caktojë një seancë dëgjimore brenda 20 ditësh nga lëshimi dhe të vendosë nëse do ta zëvendësojë me një urdhër mbrojtjeje të rregullt ose jo.

Të paditurit do t'i kërkohet të jetë i pranishëm në seancë, por nëse ai ose ajo nuk paraqitet, seanca do të vazhdojë normalisht për sa kohë i padituri është njoftuar. Mosfunksionimi i sistemit postar nuk përbën arsye për të shtyrë seancën dëgjimore.

A MË DUHET TË SHKOJ NË GJYKATË PËR TË NXJERRË NJË URDHËR MBROJTJEJE?

Po. Përpara gjykatës ju do të njiheni si paditësi, ndërsa dhunuesi do të njihet si i padituri.

Gjykata duhet t'ju japë juve gjithmonë dy kopje të vendimit origjinal mbi urdhrin e mbrojtjes, (qoftë ky urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje). Një kopje mbajeni për përdorim personal, ndërsa një kopje mbajeni për t'ia paraqitur policisë nëse do të jetë e nevojshme.

Nëse ju ose avokati juaj nuk paraqiteni në seancën gjyqësore, pa komunikuar arsyet e mungesës suaj, procedimi pushohet. Ju mund ta rinisni atë, duke paraqitur sërish të njëjtën kërkesë ose një kërkesë tjetër.

A MUND T'I MBROJË URDHRI I MBROJTJES FËMIJËT E MI?

Po. Ju mund të kërkoni që urdhri i mbrojtjes ose urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes të jetë i zbatueshëm edhe për fëmijët tuaj. Gjyqtari mund ta urdhërojë dhunuesin që të qëndrojë larg shkollës së fëmijëve, larg shtëpisë së familjes dhe larg çdo vendi tjetër ku ju dhe fëmijët tuaj mund të jeni në rrezik. Gjithashtu, gjykatësi mund të kufizojë ose të ndalojë të drejtën e dhunuesit për të parë fëmijët.

Me anë të një urdhri mbrojtjeje, gjykatësi mund t'ju japë edhe kujdestari të përkohshme të fëmijëve.

A ËSHTË E MUNDUR QË URDHRI I MBROJTJES TA DETYROJË DHUNUESIN TË PAGUAJË MBËSHTETJE FINANCIARE PËR VIKTIMËN OSE FËMIJËN?

Po, ju mund të kërkoni që mbështetja financiare për fëmijën të përfshihet në urdhrin e rregullt të mbrojtjes (por jo në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes). Dhunuesi mund të paguajë edhe detyrime financiare për ju ose për anëtarë të tjerë të familjes që janë në ngarkimin tuaj.

Gjithashtu, gjyqtari mund t'ju caktojë përkohësisht si zotëruesin e vetëm të banesës familjare, pavarësisht se kush është pronari apo emri i kujt është në kontratën e qirasë. Gjyqtari gjithashtu mund ta detyrojë dhunuesin që të paguajë qiranë për banesën tuaj të përkohshme apo të përhershme.

NËSE KËRKOJ NJË URDHËR MBROJTJEJE, A DO TË SHKOJË DHUNUESI NË BURG?

Jo. Një urdhër mbrojtjeje është një veprim civil, jo penal. Ai ligjërisht e ndalon dhunuesin që t'ju afrohet. Qëllimi i urdhrit është që të parandalojë dhunën e mëtejshme në familje, dhe të parandalojë lëndimin tuaj dhe të fëmijëve tuaj. Për sa kohë dhunuesi juaj nuk e shkel urdhrin apo përballet me akuza penale, ai apo ajo nuk do të arrestohet.

NËSE MARR NJË URDHËR MBROJTJEJE, A MUND TË NIS EDHE PROCEDIM PENAL KUNDËR DHUNUESIT TIM?

Po, mundeni. Lëshimi i një urdhri mbrojtjeje apo urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje nuk ju pengon që gjithashtu të paraqisni padi penale kundër dhunuesit për akte apo shtrëngime që përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.[2] Për shembull, nëse dhunuesi ju ka kërcënuar, përdhunuar, lënduar, ju ka mohuar mjetet e jetesës, ose ka rrëmbyer fëmijët tuaj, ju mund të paraqisni padi penale. Edhe nëse procedimi penal ndërpritet (për shkak se ju tërhiqni padinë ose autoritetet penale pushojnë çështjen), kjo nuk ju ndalon juve që të kërkoni një urdhër civil mbrojtjeje. Procedimet penale dhe civile janë të ndara nga njëri-tjetri. Kjo do të thotë që, për shembull, ju përsëri mund të nxirrni një Urdhër mbrojtjeje edhe nëse i padituri shpallet i pafajshëm nga gjykata penale. Në mënyrë të ngjashme, ju mund të ngrini padi penale edhe nëse nuk ju jepet një urdhër mbrojtjeje. Me pak fjalë, mund të ndërmerrni secilën nga këto dy masa, ose të dyja bashkë.

ÇFARË MUND TË BËJË DHUNUESI IM KUNDËR NJË URDHRI MBROJTJEJE?

Nëse i padituri nuk është dakord me urdhrin, ai mund të bëjë ankim në gjykatë. Afati i ankimit të një urdhri mbrojtjeje është 15 ditë. Afati i ankimit të një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje është 5 ditë.

Ankimi nuk ndikon mbi zbatimin e urdhrit i cili hyn në fuqi dhe zba-

2 Secili prej krimeve të mëposhtme mund të konsiderohet dhunë në familje kur kryhet midis anëtarëve të familjes nga Kodi Penal ekzistues: vrasje; kanosje; përdhunim; plagosje; ndërprerje e shtatzënisë kundër pëlqimit; mohim i ndihmës; shtytje për vetëvrasje; rrëmbim personi; trafikim; detyrim dhe shfrytëzim për prostituim; fyerje dhe shpifje; kufizim i lirisë së shprehjes/fjalës, lirisë së lëvizjes ose grumbullimit; dhunim i jetës private; akte të tjera të turpshme; braktisje; mohim i mjeteve të jetesës; marrje e paligjshme e fëmijës; shtrëngim për bashkëjetesë ose përfundim të martesës; dëmtim ndaj pronës ose mirëqenies ekonomike; kufizim i të drejtës për të administruar të ardhurat; grabitje/vjedhje; lëndime serioze, joserioze ose dëmtime të tjera të qëllimshme; lëndime serioze ose joserioze si pasojë e pakujdesisë; hyrje pa leje; përdorim keqdashës i telefonit. Gjithashtu, megjithëse veprimet e mëposhtme nuk janë të renditura në Kodin Penal ekzistues, ligji i ri i konsideron ato si dhunë në familje: refuzimi i mjeteve monetare, abuzim i drejtpërdrejtë fizik, psikologjik, seksual dhe ekonomik i fëmijëve, dhe vendosja e fëmijëve në situata të rrezikshme ku ata janë dëshmitarë të dhunës.

tohet menjëherë. Kjo do të thotë që, në pritje të apelimit (edhe përpara se të vendoset), dhunuesi juaj përsëri duhet të respektojë masat kufizuese të përcaktuara në urdhër.

PËR SA KOHË ËSHTË I VLEFSHËM NJË URDHËR MBROJTJEJE?

Kohëzgjatja e një urdhri mbrojtjeje vendoset nga gjykata, në maksimum deri në 12 muaj. Ky afat mund të zgjatet, por për këtë duhet të aplikoni të paktën 15 ditë përpara se urdhri të skadojë. Gjykata vendos edhe për kohëzgjatjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

A ËSHTË URDHRI I MBROJTJES I VLEFSHËM JASHTË QYTETIT, KOMUNËS APO BASHKISË KU JETOJ UNË?

Po, është. urdhri i mbrojtjes dhe urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes janë të vlefshëm dhe të zbatueshëm në të gjithë Shqipërinë.

NËSE NJË URDHRI MBROJTJEJE PO I MBARON AFATI, A MUND TË ZGJATET?

Po, mundeni. Të paktën 15 ditë përpara skadimit të urdhrit të mbrojtjes, ju ose një person i autorizuar nga ju mund të shkoni në gjykatë dhe të kërkoni vazhdimin e urdhrit. Gjykata merr në shqyrtim kërkesën tuaj dhe urdhëron vazhdimin e urdhrit të mbrojtjes, nëse rrethanat që kishin përcaktuar fillimisht lëshimin e tij vazhdojnë ende. Vendimi i gjykatës për të pranuar ose mohuar kërkesën tuaj mund të varet nga fakti nëse ju jeni kërcënuar, lënduar apo në rrezik dhe nëse urdhri i mbrojtjes është shkelur ose jo.

A MUND TË KËRKOJ NDIHMË NË LIDHJE ME APLIKIMIN PËR NJË URDHËR MBROJTJEJE?

Një avokat pa pagesë mund ta përgatisë kërkesën dhe ta paraqesë atë. Nëse jo, paditësi mund ta paraqesë kërkesën me anë të formularëve të gatshëm (shih shtojcat C, D dhe E) ose ta shkruajë me dorë në mënyrë të pastër dhe lehtësisht të lexueshme.

Pyesni nëse ka ndonjë organizatë jofitimprurëse në zonën tuaj, e cila ndihmon njerëzit që të aplikojnë vetë (shih shtojcën A).

SA PARA DO TË KUSHTOJË KËRKESA PËR NJË URDHËR MBROJTJEJE?

Gjykata nuk ngarkon asnjë tarifë për paraqitjen e kërkesës për urdhër mbrojtjeje. Nëse kërkesa plotësohet, tarifat i ngarkohen të padituri. Nëse kërkesa refuzohet, tarifat gjyqësore dhe ligjore i ngarkohen paditësit. Shuma e këtyre tarifave, veçanërisht e tarifave ligjore, mund të luhatet në mënyrë të konsiderueshme.

KUR HYN NË FUQI URDHRI I MBROJTJES?

Vendimi gjyqësor që lëshon një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje ose një urdhër mbrojtjeje përbën një titull ekzekutiv që nga çasti kur shpallet nga gjykata dhe do të zbatohet menjëherë nga përmbaruesit, policia, autoritetet e pushtetit vendor, dhe dhunuesi.

SI MUND TË VËRTETOJ QË JAM VIKTIMË E DHUNËS NË FAMILJE?

Është shumë e rëndësishme që të regjistroni provat. Provat mund të jenë fotografi të plagëve, dokumente të mëparshme gjyqësore, si p.sh., vendime për lëshim të urdhrave të mbrojtjes, ose urdhra-arresti të mëparshëm ose kartela mjekësore. Provat ndihmojnë gjykatën që të marrë një vendim të favorshëm në lidhje me lëshimin e urdhrit të mbrojtjes. Gjithashtu, ato e ndihmojnë prokurorin që të dënojë një të pandehur në një çështje penale, në rast se ju vendosni të bëni një kallëzim penal. Për të regjistruar provat, ju mund të:

- mbani një ditar me datat dhe ngjarjet që kanë ndodhur dhe kush ka qenë dëshmitar (shih shtojcën H);
- bëni fotografi të plagëve, dhe vendosni emrin tuaj dhe datën në fotografi;
- kur ju jepet trajtim mjekësor për plagë të shkaktuara nga dhuna në familje, sigurohuni që t'i thoni mjekut që të shkruajë ato që kanë ndodhur, duke dhënë edhe emrin e dhunuesit;
- mbani kopje të të gjitha dokumenteve gjyqësore. Mbani gjithmonë me vete një kopje të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose të urdhrit të mbrojtjes;

- sa herë që të flisni me policinë, kërkoni nga punonjësit e policisë që t'ju tregojnë dokumentet e identifikimit, merruni emrat, numrat e telefonit, komisariatin e policisë dhe informacione të tjera kontakti;
- kur denonconi një incident, sigurohuni që të dini nëse policët kanë dorëzuar ose jo një proces-verbal. Nëse po, merrni një kopje të raportit të policisë (ose të paktën merrni numrin e proces-verbalit). Sigurohuni që të kuptoni nëse duhet të ndërmerrni hapa të mëtejshëm;
- nëse merrni letra kërcënuese ose bezdisëse nga dhunuesi, mos i hidhni. Bëni një kopje dhe origjinalin jepjani policisë.

ÇFARË PROVASH MUND TË PARAQITEN NË SEANCËN DËGJIMORE GJYQËSORE?

Në seancën dëgjimore për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata mund të marrë në konsideratë si prova deklarata të dëshmitarëve, raporte policore, raporte mjekësore, akt-ekspertime, ekzaminime dhe pohime/shpjegime të palëve, dokumente të tjera të lëshuara nga punonjësit social të departamentit të shërbimeve sociale, dokumente të lëshuara nga persona juridikë. Duke qenë se urdhrin po e kërkoni ju, ju duhet të shkoni e t'i tregoni gjykatës që abuzimi ka ndodhur vërtet. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që të keni të paktën disa nga provat e renditura më lart. Pasi ta keni bërë këtë, i padituri do të përpiqet që ta bindë gjykatësin që dhuna nuk ka ndodhur asnjëherë.

KUSH MUND TË DËSHMOJË NË SEANCË?

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, gjykata mund të dëgjojë dëshminë e personave të mëposhtëm:

- viktimën, përfaqësuesin ligjor ose avokatin e saj/tij;
- dhunuesin, përfaqësuesin ligjor ose avokatin e tij/saj;
- prokurorin, nëse ky ka paraqitur kërkesën;
- përfaqësuesin e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës së banesës së përkohshme ose të përhershme të pa-

ditësit, kur paditësi është i mitur ose nuk ka zotësi për të veprua-ar, ose kur dhuna familjare ndikon mbi këto kategori/persona;

- punonjësit e qendrave shëndetësore të cilët kanë asistuar viktimën pas ushtrimit të dhunës mbi të;
- çdo dëshmitar tjetër i vlerësuar si i domosdoshëm nga gjykata.

SI MUND TA NDRYSHOJ APO TA ANULOJ URDHRIN?

E vetmja mënyrë për ta modifikuar ose pushuar urdhrin është që të paraqisni një ankim. Sjellja e palëve ose ndonjë marrëveshje e supozuar midis tyre nuk mund ta ndryshojë urdhrin e gjykatës.

Viktima, avokati i viktimës ose prokurori, kur ky i fundit ka plotësuar kërkesën, mund të paraqesë një kërkesë për pushimin ose ndryshimin e urdhrit vetëm kur ka një ndryshim "themelor" të rrethanave. Gjykata vendos për kërkesën në bazë të një seance dëgjimore. Kërkesa vetë nuk e pezullon urdhrin e mbrojtjes, i cili vazhdon të mbetet në fuqi.

Pas seancës, gjykata mund ta mbajë urdhrin e mbrojtjes të pandryshuar, ta ndryshojë nëse rrethanat kanë ndryshuar thellësisht, ose ta pushojë nëse masat mbrojtëse nuk janë më të nevojshme.

KUSH NJOFTOHET PËR URDHRIN E MBROJTJES?

Pas lëshimit të urdhrit të mbrojtjes, urdhri hyn në fuqi menjëherë dhe zbatimi i tij fillon pavarësisht nëse i padituri është njoftuar ose jo. I padituri që nuk paraqitet duhet të njoftohet menjëherë mbi urdhrin. Brenda 24 orëve, gjykata u dërgon kopje të urdhrit të mbrojtjes: viktimës dhe personave të tjerë të përmendur në urdhrin e mbrojtjes; prokurorit, kur ky ka paraqitur kërkesën; zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës ku viktima, ose personat e tjerë të përmendur në urdhrin e mbrojtjes, kanë banim të përkohshëm ose të përhershëm; komisariatit të policisë së vendndodhjes ku viktima ose personat e tjerë të përmendur në urdhrin e mbrojtjes kanë banim të përkohshëm ose të përhershëm.

ÇFARË DUHET TË BËJ UNË NËSE DHUNUESI THYEN URDHRIN E MBROJTJES?

Shkelje të urdhrit përbën çdo gjë që ndalohet nga kushtet e urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Nëse dhunuesi juaj shkel urdhrin ose nëse besoni se mund të jeni në rrezik, njoftoni menjëherë policinë. Mos harroni të mbani gjithmonë me vete një kopje të urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Kur të denonconi shkeljen tregojani urdhrin policisë. Policia duhet ta regjistrojë faktin në një raport të shkruar, dhe t'ju japëe një kopje të raportit me numrin e ngjarjes.

Zbatimi i detyruar i urdhrit të gjykatës kryhet nga shërbimet e përmbarimit. Nëse i padituri refuzon të bindet, autoritetet (policia, përmbaruesit) do të vazhdojnë me ekzekutim të detyruar. Se çfarë ndodh me dhunuesin, varet nga situata specifike. Ai/ajo mund të urdhërohet që të paguajë një gjobë prej 50.000 lekësh ose të dënohet me heqje lirie deri në 2 vjet. Gjithashtu, policia dhe prokuroria duhet të bëjnë kallëzim penal për çdo vepër penale të kryer.

Disa shembuj të thyerjes së urdhrit janë:
- telefonon në shtëpi ose punë;
- vjen në shtëpi;
- viziton fëmijët në shkollë;
- kërcënon;
- dëmton pronën;
- përdor dhunë fizike.

Është e rëndësishme që të gjitha shkeljet t'i raportohen policisë, edhe pse në dukje mund të jenë të vogla. Nëse policia është në dijeni të një sërë shkeljesh të vogla, kjo e ndihmon të ndërtojë një panoramë të asaj që po ndodh. Një incident i izoluar mund të mos duket aq serioz sa për të ndërmarrë ndonjë veprim, por shumë incidente të ngjashme, me kalimin e kohës, mund të kenë një efekt serioz mbi ju. Regjistroni çdo shkelje dhe gjithashtu kontaktoni avokatin tuaj ose qendrën e grave nëse urdhri shkelet.

Nëse, duke shkelur urdhrin, dhunuesi ka kryer një vepër penale, justifikimi se nuk mund ta kontrollonte veten nuk mund të merret parasysh në mbrojtje të dhunuesit, deri atëherë kur personi diagnostikohet vërtetë me sëmundje mendore. Sidoqoftë, kjo mund të përdoret për të përcaktuar vetëm shkallën e dënimit dhe jo fajin. Nëse ka një procedim penal, as të qenit i dehur ose nën efektin e drogës nuk mund të merret parasysh në mbrojtje të dhunuesit. Nëse dhunuesi dehet me qëllim, kjo është një rrethanë rënduese. Fakti që dhuna është drejtuar brenda familjes, kundër një fëmije, gruaje shtatzënë ose një personi të pafuqishëm duhet ta bëjë ndëshkimin më të ashpër.[3]

A DO TË MË MBROJË MUA URDHRI I MBROJTJES?

Jo domosdoshmërisht. Studime në vende të tjera tregojnë që urdhrat e mbrojtjes reduktojnë, por nuk eliminojnë, rrezikun e dhunës së mëtejshme. Disa dhunues i respektojnë këto urdhra, të tjerë jo. Në disa raste, kërkesa për një urdhër mbrojtjeje mund t'ju vendosë juve në rrezik edhe më të madh. Është mirë që të konsideroni mundësinë për të lëvizur në një strehë për viktimat e dhunës në familje ose në shtëpinë e një miku të panjohur nga dhunuesi. Por nëse nuk largoheni nga partneri abuzues, mund të jetë jashtëzakonshmit e rrezikshme për një kohë afatgjatë, pasi dhuna në familje shpesh përshkallëzohet. Besojini instinktit tuaj dhe bëni ç'është e mundur për të mbrojtur veten dhe për të qëndruar jashtë rrezikut.

A DUHET T'I THEM PUNËDHËNËSIT TIM PËR URDHRIN E MBROJTJES APO PËR URDHRIN E MENJËHERSHËM TË MBROJTJES?

Kjo është në dorën tuaj për ta vendosur. Ekzistojnë arsye të forta për ta njoftuar punëdhënësin tuaj. Për shembull, një kolegu juaj i painformuar mund t'i japë dhunuesit informacion personal mbi ju, që ju nuk doni që ai ta mësojë. Ndoshta mund të jeni i/e shqetësuar se do të humbisni vendin e punës nëse e vini punëdhënësin në dijeni të rrethanave tuaja. Punëdhënësit, gjithsesi, nuk duhet t'ju pushojnë nga puna thjesht

3 Kodi Penal Shqiptar, neni 50 (e) dhe (h).

sepse jeni viktimë e dhunës në familje. Dhe nëse shefat tuaj janë në dijeni të rrezikut të mundshëm, ata do të jenë më të aftë që t'ju ndihmojnë ju dhe kolegët tuaj për t'ju mbrojtur. Për shembull, personeli i sigurimit të vendit të punës mund të paralajmërohet që të mbajë sytë hapur për dhunuesin - dhe t'ju njoftojë nëse ai ose ajo afrohet në ndërtesë.

KUJT TJETËR MUND T'I DREJTOHEM PËR NDIHMË DHE PËRKRAHJE?

Ekzistojnë një numër organizatash jofitimprurëse të cilat punojnë për të drejtat e grave dhe ofrojnë ndihmë për viktimat e dhunës në familje. Mund të gjeni një listë të këtyre organizatave në shtojcën A.

SHTOJCA A

LISTA E ORGANIZATAVE DHE STREHAVE QË PUNOJNË ME VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE

ORGANIZATA JOFITIMPRURËSE

Tiranë

Shoqata "Refleksione"
Adresa: Rr. e Elbasanit, Pallatet "Fratari",
Tërshana 2, Kati i I rë, Shk.2,
Kutia Postare 2412/1
Tiranë
Tel./faks: 04 340433/4
E mail: refleksione@icc al.org

Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza
Adresa: Rr. "Sami Frashëri", Pall.9, Shk.5,
Kutia Postare 2416/1
Tiranë
Tel.: 04 233408
E mail: qkgv@albnet.net

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare
Adresa: Rr. "Vaso Pasha", Pall.12, Shk.1, Ap.1,
Tiranë
Tel./faks: 04 241914
E mail: avokatore@albmail.com, aurboz@yahoo.com

Qendra e të Drejtave të Njeriut në Demokraci
Adresa: Kutia Postare 2901
Tiranë
Tel./faks: 04 230084
E mail: aprroni@yahoo.com; hrdc@interalb.net

Durrës

Qendra Sociale për Gra dhe Vajza
Adresa: Lagjja 11, Rr. "Baki Çelmeta"
(pranë Restorantit "Pranvera")
Durrës
Tel./faks: 05223815
E mail: shoqataegrave@yahoo.com

Elbasan

Forumi i Gruas Elbasan
Adresa: Lagjja "5 Maji", Rr. "Fetah Ekmeciu", Pall.450/1
Elbasan
Tel./Faks: 0545 5509, 0545 40051
E mail: forumi gruaselbasan@yahoo.com

Në Dobi të Gruas Shqiptare
Adresa: Lagjja "5 Maji", pranë ish Parkut të Mallrave
Elbasan
Tel./faks: 054 57582
E mail: manajb@enet.org.al

Shkodër

Gruaja te Gruaja
Adresa: Rr. "Marlin Barleti", sipër Kristalit,
përballë Kinemasë Millenium
Shkodër
Tel.: 022 4 1154, 022 4 5234
E mail: gtg@adanet.com.al

Qendra e Gruas "Hapat e Lehtë"
Adresa: Rr. "Branko Kadia",
Lagjja "3 Heronjtë", Nr. 57,
Shkodër
Tel.: 022 44022
E mail: qendragruashk@yahoo.com

"The Door"
Adresa: Lagjja "Naim Gjylbegu"
Rruga "Bujar Bishanaku"
Shkodër
Tel.: 022 43729
E mail: thedoor@infothedoor.com

Shoqata "Refleksione" Shkodër
Adresa: Rr. Marlin Barleti, Lagjja Ndoc Madhi, Pall. 166
Shkodër
Tel.: 022 48444
E mail: refleksioneshk@albnet.net

Kukës

Qendra e Këshillimit dhe e Shërbimeve Sociale Kukës
Adresa: Lagjja 2, prapa Hotelit "Gjallica"
Kukës
Tel.: 024 24278
Celular: 0692244911
E mail: wcckukes@yahoo.com

Berat

Qendra e Grave "Kristal"
Adresa: Pallati i Kulturës "Margarita Tutulani"
Berat
Tel.: 032 31 004
E mail: qkgv@yahoo.com

Ndihmë Sociale Gruas Kryefamiljare
Adresa: Lagjja "Llukan Prifti"
Kuçovë
Celular 0692296445
E mail: teftansgk@yahoo.com

Korçë

Gruaja Korçare
Adresa: Bulevardi "Republika", Pall. 3, A.1,
Korçë
Tel.: 082 43 563
E mail: korcawomen@yahoo.com

Shoqata "Unë Gruaja"
Adresa: Rr. "Rreshit Çollaku"
Pogradec
Tel.: 083 22 140
Faks: 083 25104
E mail: une gruaja@yahoo.com

Shoqata "Refleksione" Pogradec
Adresa: Rr. Rreshit Çollaku, Lagjja 1,
Pogradec
Tel.: 063 22 115
E mail: refleksionepo@albnet.net

STREHA PËR GRATË

Tiranë

Strehëza për Gra dhe Vajza
Tiranë
Tel.: 04 261885

Vlorë

Qendra "Vatra"
Adresa: Rr. Vlorë Skelë, Pallati i Bankës Italo Shqiptare,
Kati i III të, Vlorë
Tel./faks: 033 24078, 033 28048
E mail: qvatra@icc al.org, qvatra@abcom al.com

Gjirokastër

Qendra Komunitare, Gjirokastër
Adresa: Lagjja "18 Shtatori"
Pranë Universitetit "Eqrem Çabej",
Gjirokastër
Tel.: 08468866
Celular: 0692059427
E mail: idrizi bardha@yahoo.com

SHTOJCA B

LIGJ
Nr.9669, datë 18.12.2006

PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e 20 mijë zgjedhësve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:
1. Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore.
2. Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktima të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe perso nave me aftësi të kufizuar.

Neni 2
Objekti

Ky ligj ka si objekt:
a) krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;
b) orientimin e punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje;
c) fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje;
ç) sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pa kushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, me termat e mëposhtëm kuptojmë:
1. "Dhunë" është çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.
2. "Dhunë në familje" është çdo akt dhune, sipas pikës 1 të këtij neni, i ushtruar midis per sonave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare.
3. "Pjesëtarë të familjes" janë:
a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish bashkëshorti/ja apo ish partneri/ja bash këjetues;
b) vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adop tuar;
c) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i personave të parashikuar në shkronjën "b";
ç) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/ es ose bashkëjetuesit/es;
d) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 muajve të fun dit;
dh) fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues.
4. "Viktimë" është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.
5. "Dhunues/e" është personi i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente.
6. "Urdhër mbrojtjeje" është urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën.
7. "Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje" është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate.

Neni 4
Subjektet

Subjektet që mbrohen nga ky ligj janë të gjithë personat e cilësuar në nenin 3 pika 3 të këtij ligji.

KREU II
ORGANET PËRGJEGJËSE

Neni 5
Autoritetet përgjegjëse

1. Autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
2. Autoritete të tjera përgjegjëse të linjës janë:
a) njësitë e qeverisjes vendore;

b) Ministria e Brendshme;
c) Ministria e Shëndetësisë;
ç) Ministria e Drejtësisë.

Neni 6
Detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës

Autoriteti kryesor përgjegjës ka këto detyra:
a) hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;
b) financimin ose bashkëfinancimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe kon solidimin e familjes, si dhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;
c) mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse, si dhe të gjithë infrastrukturës së nevojshme, që shërben për një mbështetje dhe plotësim të të gjitha nevojave për personat e dhunuar në marrëdhëniet familjare, përfshi këtu asistencë financiare, si dhe shërbime mjekësore dhe sociale, sipas legjislacionit në fuqi;
ç) organizimin e kurseve të trajnimit rreth dhunës në familje me punonjësit e shërbimeve sociale, që janë të atashuar pranë çdo njësie vendore, strukturat e Policisë së Rendit dhe me punonjësit e OJF ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale;
d) mbajtjen e të dhënave statistikore për nivelin e dhunës në familje;
dh) mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për viktimat e dhu nës në familje;
e) mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për shkaktarët e dhu nës në marrëdhëniet familjare;
ë) licencimin e OJF ve të ndryshme që do të ofrojnë shërbime sociale për viktimat dhe dhunuesit.

Neni 7
Detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës

1. Ministria e Brendshme ka këto detyra:
a) krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë drejtorive të policisë;
b) trajnimin e efektivave e policisë që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje.
2. Ministria e Shëndetësisë ka për detyrë të krijojë kapacitetet e duhura për të ofruar ndihmë mjekësore për dhunën në familje në shërbimet e urgjencës dhe në qendrat shëndetësore në bashki dhe komuna:
a) për të ofruar në çdo kohë ndihmë mjekësore dhe psikologjike për viktimat e dhunës në familje;
b) për të bërë në çdo kohë ekzaminimet e nevojshme në institucionet shëndetësore publike përkatëse;
c) për të evidentuar rastet e dhunës në familje në dokumentacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë;
ç) për të pajisur edhe viktimën me raportin mjekësor përkatës;
d) për të referuar dhe orientuar viktimën pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.

3. Ministria e Drejtësisë ka këto detyra:
a) të trajnojë ekspertët mjeko ligjorë në njohjen, diagnostikimin, vlerësimin dhe raportimin e dhunës në familje dhe akteve të dhunës ndaj fëmijëve;
b) të trajnojë përmbaruesit në detyrën e tyre për të ekzekutuar urdhrat e mbrojtjes në mënyrë të menjëhershme, të sigurojë përmbushjen e tyre në përputhje me nenin 23 pika 6, si dhe për të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura;
c) të financojë mbrojtje ligjore falas, sipas parashikimeve në ligj dhe të sigurojë një numër të caktuar avokatësh të trajnuar, që mund të japin një asistencë të tillë.
4. Njësitë e qeverisjes vendore (bashkitë, komunat) kanë këto detyra:
a) angazhimin në krijimin e strukturave të shërbimit social për rastet e dhunës në familje;
b) instalimin e një linje telefonike rajonale 24 orëshe, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore dhe OJF të, duke vendosur në këtë mënyrë edhe koor dinimin mes tyre;
c) ngritjen e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit, si dhe koor dinimin e punës me ato ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse.

Neni 8
Përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse

1. Autoritetet përgjegjëse kanë për detyrë krijimin e strukturave të posaçme dhe caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. Përmbushja e këtij detyrimi mbikëqyret nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
2. Autoritetet përgjegjëse kanë detyrimin t'i përgjigjen çdo njoftimi të bërë nga viktima apo personat e tjerë të treguar në këtë ligj, në rastet e dhunës apo kërcënimit për dhunë ose dhe në rastet e shkeljes së urdhrit të mbrojtjes apo urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Ato mbajnë raportin përkatës dhe një kopje ia dorëzojnë viktimës ose shoqëruesit të saj.
3. Autoritetet përgjegjëse përdorin mjetet e arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar vazhdimin e dhunës me anë të:
a) informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj për masat që do të merren sipas ligjit në fuqi dhe për institucionet të cilave duhet t'u drejtohet;
b) informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj në lidhje me shërbimet sociale ekzistuese dhe shoqërimit në qendrat dhe institucionet përkatëse;
c) sigurimit të transportit për viktimën dhe shoqëruesin e saj në qendra shërbimesh mjekë sore apo sociale;
ç) vënies në dispozicion të një punonjësi të policisë në rastet e rrezikut për jetën.
4. Nëse ekziston dyshimi se dhunuesi ka kërcënuar ose ka ushtruar dhunë në familje apo ka thyer urdhrat e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, organet e policisë do të bëjnë konstatimet e menjëhershme.
5. Personat të cilët marrin dijeni për shkak të detyrës apo autoritetit të ngarkuar për zbatimin e këtij ligji dhe nuk veprojnë në zbatim të tij, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose penale, duke zbatuar sanksione të përcaktuara në nenet 248 dhe 251 të Kodit Penal.
6. Organet e policisë kanë për detyrë të regjistrojnë konstatimet përkatëse në një raport të shkruar, si dhe të fillojnë hetimet kryesisht. Viktima vihet në dijeni nga policia për numrin përkatës të rastit të raportuar.

Neni 9
Subjektet që mund të vënë në dijeni organet përgjegjëse

1. Në rast të dhunës në familje, viktima mund t'i drejtohet me anë të një kërkese postës së policisë më të afërt (të zonës ku banon ose ndodhet), njësisë përkatëse vendore (komunë, bashki), qendrës shëndetësore të zonës ku banon apo ndodhet ose me kërkesë padi gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së saj ose të dhunuesit/es, për të marrë masat e nevojshme.
2. Çdo person që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje mund t'u drejtohet me anë të një kërkese autoriteteve të mësipërme për të ndërmarrë masat e nevojshme.

KREU III
MASAT MBROJTËSE

Neni 10
Masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje

1. Mbrojtja ndaj dhunës në familje, në zbatim të këtij ligji, do të sigurohet me këto mënyra:
a) duke urdhëruar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë vepër të dhunës në familje ndaj paditësit/es (viktimës) apo pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;
b) duke urdhëruar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën apo pjesëtarë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;
c) duke larguar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) nga banesa për një afat kohor të caktuar me urdhër të gjykatës dhe të mos e lejojë të rihyjë në banesë pa autorizimin e gjykatës;
ç) duke ndaluar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;
d) duke ndaluar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që t'i afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës apo banesës së çiftit të ardhshëm ose të personave të tjerë dhe për më tepër shkollës së fëmijëve, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktima, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;
dh) duke vendosur menjëherë viktimën/at dhe të miturit në strehime të përkohshme, duke mbajtur parasysh në çdo rast interesin më të lartë, atë të të miturit;
e) duke kufizuar ose duke ndaluar të paditurin/ën (dhunuesin/en) të takohet me fëmijën e viktimës, sipas kushteve të cilat mund të jenë të përshtatshme;
ë) duke i ndaluar të paditurit/ës (dhunuesit/es) hyrjen ose qëndrimin në banesën e për kohshme apo të përhershme të viktimës, ose në ndonjë pjesë të saj, pavarësisht nga të drejtat e pronësisë apo të posedimit të dhunuesit;
f) duke urdhëruar një person të autorizuar nga gjykata (punonjës i rendit ose përmbarues

gjyqësor) që të shoqërojë viktimën ose të paditurin/ën (dhunuesin/en) deri në banesën e viktimës dhe të mbikëqyrë largimin e pasurisë personale;
g) duke urdhëruar organet zbatuese të ligjit që të konfiskojnë çdo armë që i përket dhunues it gjatë kontrollit të kryer apo të urdhërojë dhunuesin për të dorëzuar çdo armë që i përket atij;
gj) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të lejojë viktimën të posedojë banesën të cilën e përdorin së bashku viktima dhe dhunuesi/ja ose ndonjë pjesë të saj;
h) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të paguajë qeranë e banesës së përhershme apo të përkohshme të viktimës, si dhe detyrimin ushqimor për viktimën, fëmi jët apo pjesëtarë të tjerë të familjes që ka në ngarkim;
i) për sa kohë urdhri mbrojtës është në fuqi, trajtimi i pasurisë kryhet në përputhje me Kodin e Familjes, nenet 57, 58 dhe 60;
j) duke i kaluar viktimës të drejtën e kujdestarisë së përkohshme mbi fëmijët dhe duke i hequr përkohësisht përgjegjësinë prindërore të paditurit/ës (dhunuesit/es);
k) duke vendosur dhe duke urdhëruar sipas rastit (në kompetencë të gjykatës) ndërhyrjen e shërbimeve sociale, publike apo private të vendbanimit ose pranë organizatave që kanë si qëllim mbështetjen dhe pritjen e personave të dhunuar në familje;
l) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të bëjë një pagesë periodike në favor të personave bashkëjetues, të cilët, për efekt të masës së mësipërme, mbeten të privuar nga mjetet e jetesës. Për të siguruar pagesën, gjykata mund të vendosë që shuma të derdhet nga punëdhënësi në favor të përfituesit. Një vendim i tillë përbën titull ekzekutiv;
ll) duke përfshirë viktimën e dhunës në familje në programe rehabilitimi;
m) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) të marrë pjesë në programe rehabili timi; nëse i/e padituri/a (dhunuesi/ja) urdhërohet të shkojë në një program rehabilitimi, përgjegjësve të programit u kërkohet të raportojnë çdo javë në gjykatë nëse dhunuesi e ndjek apo merr pjesë në të. Nëse i/e padituri/a (dhunuesi/ja) nuk merr pjesë, atëherë, me kërkesë të subjekteve të parashikuara nga neni 13 i këtij ligji, gjykata e thërret këtë përpara saj dhe zbaton dispozitat përkatëse të Kodit Penal, për pengimin e ekzekutimit të vendi meve të gjykatës.
2. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, mund të parashikohen disa nga masat mbrojtëse të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.
3. Në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar me vendimin e gjykatës, mund të parashikohen disa nga masat e parashikuara në shkronjat "a" deri në "g" të këtij neni.
4. Në rastin e zbatimit të shkronjës "g" të këtij neni, gjykata mban parasysh:
a) nëse arma është konfiskuar, ajo mund të kthehet vetëm pas mbarimit të urdhrit të mbrojtjes dhe marrjes së një urdhri nga gjykata;
b) nëse arma është konfiskuar dhe personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje, gjyka ta njofton autoritetin përkatës administrativ, ose pezullon lejen e armës derisa të mbarojë urdhri mbrojtës.

Neni 11
Efektet e urdhrit të mbrojtjes

1. Pavarësisht prej ndonjë urdhri apo vendimi tjetër të nxjerrë nga gjykata apo ndonjë in stitucion tjetër, urdhri i mbrojtjes që përmban masat e mësipërme do të nxirret me vendim gjykate për rastet e parashikuara nga ky ligj.

2. Urdhri i mbrojtjes ose urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i nxjerrë me vendim gjykate, apo përfundimi i efekteve të tij nuk cenon në mënyrë të përhershme të drejtat e pronësisë apo të kujdestarisë.

KREU IV
GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDHRIT TË MBROJTJES

Neni 12
Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje

1. Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje është gjykata e rrethit gjyqësor, seksioni familjar.
Për të vendosur sigurimin e masave mbrojtëse të përmendura në nenin 10 të këtij ligji, gjykata lëshon urdhra mbrojtjeje dhe urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje.
2. Pala e interesuar mund t'i kërkojë gjykatës, sipas rastit, konform dispozitave të këtij ligji, lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, pa kërkuar paraprakisht nxjerrjen e urdhrit të menjëher shëm të mbrojtjes.
3. Pasi gjykata të ketë lëshuar një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, pala e interesuar mund të kërkojë lëshimin e një urdhri mbrojtës, siç parashikohet në këtë ligj. Urdhri mbrojtës për katës shërben për të rikonfirmuar vazhdimësinë e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe siguron masat mbrojtëse të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.

Neni 13
Subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes

1. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje mund ta paraqesin:
a) vetë viktima;
b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
c) policia / prokuroria.
2. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje të një të mituri mund ta paraqesin:
a) prindi ose kujdestari i të miturit;
b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
c) të afërmit;
ç) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktima, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;
d) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
3. Kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje mund ta paraqesin:
a) vetë viktima;
b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
c) policia/prokuroria;
ç) personi me të cilin viktima ka marrëdhënie familjare;
d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e

përhershëm apo të përkohshëm viktima, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;
dh) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
4. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

Neni 14
Forma e kërkesë-padisë

1. Kërkesë padia për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes duhet të përmbajë edhe:
a) të dhëna personale rreth familjes ose marrëdhënieve farefisnore mes viktimës dhe dhunuesit;
b) përshkrimin e qartë të fakteve dhe rrethanave, në të cilat ka ndodhur akti i dhunës në familje, duke përfshirë arsyet që sqarojnë cenimin e sigurisë, të shëndetit apo të mirëqenies së viktimës nga i/e padituri/a (dhunuesi/ja) të parashikuara në nenin 3 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji;
c) masat mbrojtëse të posaçme që kërkohen;
ç) nënshkrimin e kërkuesit.
2. Kërkesë padia për urdhër mbrojtjeje mund të paraqitet në çdo kohë para gjykatës nga ana e personave që legjitimohen për ta kërkuar atë. Në rastet kur kërkohet ndihmë e menjëher shme, kërkesa mund të plotësohet dhe të paraqitet pranë komisariatit më të afërt të policisë dhe punonjësi i policisë vepron në përputhje me ligjin "Për Policinë e Shtetit".
3. Për hartimin e kërkesë padisë, përgatitjen e akteve dhe paraqitjen e tyre në gjykatë kërkuesi asistohet nga një avokat falas.
4. Kërkuesi shkarkohet nga taksat e gjykatës. Me daljen e urdhrit të mbrojtjes, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje. Në rast të kundërt, shpen zimet gjyqësore i ngarkohen kërkuesit.
5. Kërkesë padia regjistrohet në një regjistër të veçantë dhe protokollohet ditën e dorëzimit të saj.

Neni 15
Provat në procesin gjyqësor

1. Provat që duhet t'i paraqiten gjykatës mund të jenë: dëshmi, raporte të policisë, raport mjekësor, akt ekspertimi, ekzaminime dhe shpjegime/pohime të palëve, dokumente të tjera të lëshuara nga punonjësit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësive vendore, doku mente të lëshuara nga persona juridikë (OJF), të regjistruara sipas dispozitave në fuqi.
2. Kur nga të dhënat e kërkesës bëhet e qartë se komisariatet e policisë, organet e pushtetit vendor apo qendrat shëndetësore kanë prova shkresore lidhur me ushtrimin e dhunës në familje, ato lëshojnë menjëherë një kopje të certifikuar (kopje me vulë) për këtë në bazë të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi ose të vetë gjykatës. Në rast të moslëshimit të doku mentit të mësipërm, personat përgjegjës do të mbajnë përgjegjësi ligjore, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative.
3. Kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në

të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet.

Neni 16
Gjykimi për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes

1. Gjykata vendos shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes brenda 15 ditëve pas pranimit të kërkesës.
2. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtjeje, gjykata dëgjon me radhë personat në vijim:
a) viktimën, përfaqësuesin ligjor apo avokatin e saj;
b) të paditurin/ën (dhunuesin/en), përfaqësuesin ligjor apo avokatin e tij/saj;
c) prokurorin, nëse ky ka paraqitur kërkesën;
ç) përfaqësuesit e policisë;
d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësisë në të cilën jeton përherë ose për kohësisht personi i përmendur, kur kërkuesi është nën 18 vjeç, nuk ka zotësi për të vepruar apo dhuna e ushtruar në familje ka ndikim mbi personat e lartpërmendur;
dh) punonjësit e qendrave shëndetësore apo të qendrave të shërbimit dhe rehabilitimit, të cilët kanë asistuar viktimën pas ushtrimit të dhunës mbi të;
e) dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.
3. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

Neni 17
Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes

1. Gjykata mund të lëshojë me vendim një urdhër mbrojtjeje vetëm ndaj dhunuesit të për mendur në kërkesë padi. Ky vendim përmban vetëm masat mbrojtëse që përshkruhen në nenin 10 të këtij ligji. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse vërteton se:
a) ekzistojnë dyshime të arsyeshme për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti të dhunës në familje;
b) lëshimi i urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate është i nevojshëm për të mbrojtur sigu rinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës/ave, urdhër në të cilin, përveç kërkuesit, gjykata çmon se mund të përfshihen edhe persona të tjerë, me të cilët kërkuesi ka lidhje familjare ose intime, që mund të bëhen shkak për ushtrimin e dhunës ndaj këtyre të fundit.
2. Gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrit të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor , ku përfshihet njëra prej palëve.
3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, i cili, përveçse përm bush kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban:
a) masën e caktuar nga gjykata;
b) kohëzgjatjen e masës, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj, por me të drejtë shtyrjeje;
c) njoftimin se shkelja e urdhrit të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, përbën vepër penale në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal;
ç) njoftimin për të drejtën e ankimit ndaj urdhrit të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, brenda 15 ditëve nga shpallja apo marrja dijeni e tij.

4. Urdhri i mbrojtjes, i lëshuar me vendim gjykate, i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore, sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile. Viktima duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njërën prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrën ta vërë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.
5. Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:
a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;
b) prokurorit, nëse ka bërë kërkesë;
c) zyrës së shërbimeve sociale të njësive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;
ç) komisariatit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

Neni 18
Gjykimi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes

1. Gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës.
2. Në rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, gjykata mban një seancë ku dëgjohen personat në vijim:
a) viktima, përfaqësuesi ligjor apo avokati i saj;
b) dhunuesi/ja, përfaqësuesi apo avokati i tij/saj;
c) prokurori, nëse merr pjesë;
ç) kërkuesit e tjerë, të parashikuar në nenin 13 të këtij ligji;
d) dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

Neni 19
Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes

1. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse konstaton se:
a) ekzistojnë bazat për të besuar se i/e padituri/a (dhunuesi/ja) ka kryer ose ka kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje; ose
b) i/e padituri/a (dhunuesi/ja) paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e viktimës dhe të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës; ose
c) lëshimi i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes me vendim gjykate është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës apo të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, që mbrohen me anë të urdhrit të mbrojtjes.
2. Gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor, ku përfshihet njëra prej palëve.
3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, i cili duhet të plotësojë kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban:
a) masën e caktuar nga gjykata;
b) kohëzgjatjen e masës, e cila mbaron në momentin që fillon të zbatohet urdhri i mbrojtjes

i vendosur nga gjykata;
c) njoftimin se shkelja e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes përbën vepër penale, në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal;
ç) njoftimin për të drejtën e ankimit kundër vendimit brenda 5 ditëve nga shpallja apo ma rrja dijeni e tij;
d) datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, e cila është bren da 20 ditëve prej lëshimit të tij me vendim gjykate.
4. Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar me vendim gjykate, i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore, sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile.
Viktima duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njërën prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrën ta vërë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.
5. Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të vendimit, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:
a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;
b) kërkuesve në kuptim të nenit 13 të këtij ligji;
c) zyrës së shërbimeve sociale të njësive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;
ç) komisariatit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.
6. Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekze kutiv dhe ekzekutohet menjëherë nga zyra e përmbarimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (nenet 510/e, 516/c e vijues).

Neni 20
Gjykimi për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes

Pas përfundimit të seancës gjyqësore për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata vazhdon seancën për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes mbi bazën e kërkesës, në zba tim të nenit 16 të këtij ligji. Në përfundim të procesit gjyqësor gjykata:
a) vendos anulimin, si dhe ndërprerjen e efekteve të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate, kur ky i fundit nuk arrin të provohet;
b) refuzon lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate, kur nuk arrin të provohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar më parë me vendim gjykate;
c) lëshon urdhrin e mbrojtjes me vendim gjykate në bazë të nenit 17 të këtij ligji. Sipas nevojës, ky vendim mund t'i ndryshojë kushtet e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate.

Neni 21
Ankimi

1. Kundër vendimit përkatës të gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes mund të bëhet ankim i veçantë në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.
2. Kundër vendimit për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose kundër ven dimit për nxjerrjen e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate mund të bëhet ankim brenda

afateve dhe rregullave të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.
3. Paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes apo të urdhrit të mbrojtjes.

Neni 22
Rrethanat për ndryshimin, ndërprerjen dhe vazhdimin e urdhrit të mbrojtjes

1. Nëse rrethanat kanë ndryshuar rrënjësisht, viktima (përfaqësuesi i saj), dhunuesi/ja ose prokurori, nëse ka marrë pjesë në proces, mund të paraqesë kërkesë për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit të mbrojtjes.
2. Pas marrjes së kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit të mbrojtjes, gjykata va zhdon shqyrtimin e kërkesës, në bazë të nenit 16 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit gjykata vendos:
a) lënien në fuqi të urdhrit të mbrojtjes;
b) ndryshimin e urdhrit të mbrojtjes nëse kjo kërkohet nga rrethanat që kanë ndryshuar rrënjësisht; ose
c) ndërprerjen e tij, nëse kriteret e përcaktuara në nenin 10 pika1 të këtij ligji nuk vlejnë më, për shkak të ndryshimit rrënjësor të rrethanave.
3. Parashtrimi i kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit të mbrojtjes nuk e pe zullon ekzekutimin e vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes.
4. Viktima ose përfaqësuesi i autorizuar prej saj, 15 ditë para përfundimit të efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, mund të parashtrojë kërkesën për vazhdimin e tij. Nëse nuk parashtrohet kërkesa, urdhri i mbrojtjes ndërpritet automatikisht në ditën e përfundimit të efekteve të tij.
5. Pas marrjes së kërkesës për vazhdimin e urdhrit të mbrojtjes, gjykata vazhdon me shqyrtimin e kërkesës, në bazë të nenit 16 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit gjykata ven dos:
a) vërtetimin e ndërprerjes së urdhrit të mbrojtjes në datën e përfundimit të efekteve të tij; ose
b) vazhdimin e efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, nëse vlejnë kriteret e përcaktuara në nenin 17 pika1 të këtij ligji.

Neni 23
Ekzekutimi i vendimit gjyqësor

1. Vendimi gjyqësor, i cili përmban urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, është përfun dimtar dhe përbën titull ekzekutiv që në momentin që shpallet (ose u njoftohet palëve). Gjykata lëshon një urdhër ekzekutimi në të njëjtën kohë që lëshon urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes.
2. Vendimi gjyqësor, që përmban urdhrin e mbrojtjes, përbën titull ekzekutiv pasi të marrë formën e prerë dhe ekzekutohet menjëherë nga përmbaruesit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, komisariatet e policisë dhe njësitë e qeverisjes vendore (bashki, komuna) apo edhe vetë dhunuesi vullnetarisht. Gjykata lëshon urdhrin e ekzekutimit në të njëjtën kohë që lëshon dhe urdhrin e mbrojtjes.
3. Punonjësit socialë dhe efektivat e policisë marrin të gjitha masat për ekzekutimin e men

jëhershëm dhe të vazhdueshëm të masave mbrojtëse të vendosura konform nenit 10 të këtij ligji.
4. Institucionet, qendrat rezidenciale, qendrat e shërbimeve, OJF të e licencuara për ofrim shërbimesh zbatojnë masat e parashikura në vendimin gjyqësor dhe koordinojnë punën e tyre me njësitë e qeverisjes vendore dhe drejtoritë e policisë, si ekzekutuese direkt të këtyre vendimeve.
5. Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit të gjykatës bëhet nga zyrat e shërbimit përmbari mor, konform dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (nenet 510 e vijues).
6. Në rast të mosekzekutimit vullnetar nga organet zbatuese të vendimit të gjykatës, siç përshkruhet në pikat 2 dhe 4 të këtij neni, përfshirë dhe të paditurin/ën, të cilëve u komuni kohet vendimi, ndiqet ekzekutimi i detyruar në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. Në këto raste, ndaj personave përgjegjës për mosekzekutimin e vendimit të gjykatës zbatohen sanksionet përkatëse të parashikura në nenet 320 e 320/a të Kodit Penal, si edhe sanksionet e parashikuara në nenin 606/3 të Kodit të Procedurës Civile.

KREU V
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 24
Procedimi penal

Lëshimi i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes apo urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate nuk i ndalon palët e interesuara të nisin procesin penal, për sa i përket veprimeve apo mos veprimeve që përbëjnë figura të veprave penale.

Neni 25
Aktet nënligjore

Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 26
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 qershor 2007.

Shpallur me dekretin nr.5182, datë 12.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

SHTOJCA C

KËRKESË-PADI
PËR LËSHIMIN E URDHRIT MBROJTËS

1. DREJTUAR GJYKATËS SË RRETHITGJYQËSOR

(Emri dhe adresa e gjykatës së rrethit)

Nr. i KËRKESË-PADISË / ÇËSHTJES:

2. PADITËSI/JA[1] **Vs.** **3. I/E PADITURI/A**

(Emri, atësia, mbiemri)

(Adresa e përhershme/e përkohshme e banimit)

Numër telefoni:

Përfaqësuar nga:

(Emri i përfaqësuesit ligjor ose përfaqësuesve të tjerë, nëse ka të tjerë)

(Adresa e përfaqësuesit)

Numër telefoni:

(Emri, atësia, mbiemri)

Adresa e përhershme e banimit:

Numër telefoni:

Adresa e përkohshme e banimit:

Numër telefoni:

4. Shënoni emrin dhe adresën e viktimës/ave nëse është i ndryshëm nga emri i paditësit (emri, atësia, mbiemri)

5. SHËNIM: Nëse duke dhënë adresën keni frikë për sigurinë tuaj apo të njerëzve të tjerë nën përgjegjësinë tuaj, ju lutem jepni më poshtë një adresë tjetër të cilën dëshironi ta përdorni për qëllime të procesit gjyqësor:
Adresa:
Numri i telefonit: Të dhëna të tjera kontakti:

6. Objekti i kërkesë padisë: Lëshimi i urdhrit të mbrojtjes.

7. Kuadri ligjor: Ligji nr. 9669, datë 18 dhjetor 2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

Skicimi i formularit © Këshilli i Evropës 2007. Përdorimi i këtij formulari nuk tregon mbështetjen e Këshillit të Evropës lidhur me çështjen ose argumentet e shprehura.

1 Paditësi mund të jetë viktima ose personat e tjerë të cilët autorizohen nga viktima të kërkojnë një urdhër të menjëhershëm mbrojtje, siç parashikohet nga neni 13, pika 1 dhe 2 i ligjit nr.9669, datë 18 dhjetor 2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". Këta përsona mund të jenë përfaqësuesi ligjor i viktimës ose punonjësi i policisë/prokurori apo në rast se viktima është i/e mitur, të afërmit e të miturit/ës, përfaqësuesi i i zyrës së shërbimeve sociale ose qendrat e licensuara për mbrojtjen e viktimave.

8. Shpjegoni marrëdhënien e viktimës me të paditurin/ën (sipas shënimit të mëposhtëm):
Viktima është i/e të paditurit/ës.

SHËNIM: Pjesëtarët e familjes janë (a) Bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja; apo ish bash këshorti/ja apo ish partneri/ja bashkëjetues; (b) Vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përf shirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar; (c) Bashkëshortët e personave të mësipërm; (d) Gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es; (e) Vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 (tre) muajve të fundit; (f) Fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues.

9. Të dhëna të mëtejshme për viktimën:

Data e lindjes	
Vendi i lindjes	
Gjendja civile	
Numri i fëmijëve	
Sa fëmijë me të paditurin/ën?	
Profesioni	
Punësimi	
Nënshtetësia	
Ka pronësi në banesën e përbashkët?	
Sa veta ka në ngarkim	
Të ardhurat	

10. Të dhëna të mëtejshme për të paditurin/ën:

Data e lindjes	
Vendi i lindjes	
Gjendja civile	
Numri i fëmijëve	
Numri i personave në ngarkim	
Profesioni	
Punësimi	
Adresa e punëdhënësit	
Nënshtetësia	
Zotëron apo disponon armët e mëposhtme	
Ka pronësi në banesën e përbashkët?	
Të ardhurat	

11. Procese të tjerë ku janë të përfshirë viktimat apo fëmijët e tyre dhe i/e padituri/paditura:

Emri i çështjes	Numri i çështjes	Gjykata kompetente

12. Faktet dhe rrethanat. Shpjegoni në mënyrë të qartë e të kujdesshme faktet dhe rrethanat e incidenteve të dhunës në marrëdhëniet familjare midis viktimës dhe të paditurit/ës (nëse është e nevojshme shtoni fletë të tjera):

Incidenti nr. 1
Data:
Vendi i Incidentit:
Veprimi apo mosveprimi :
Kundër kujt (rendisni):
Efektet mbi viktimën/viktimat(rendisni):
Përshkrim i mëtejshëm i incidentit:

Njërëz të pranishëm gjatë incidentit (rendisni):

Incidenti nr. 2
Data:
Vendi i Incidentit:
Veprimi apo mosveprimi :
Kundër kujt (rendisni):
Efektet mbi viktimën/viktimat(rendisni):
Përshkrim i mëtejshëm i incidentit:

Njërëz të pranishëm gjatë incidentit (rendisni):

Incidenti nr. 3
Data:
Vendi i Incidentit:
Veprimi apo mosveprimi :
Kundër kujt (rendisni):
Efektet mbi viktimën/viktimat(rendisni):
Përshkrim i mëtejshëm i incidentit:

Njërëz të pranishëm gjatë incidentit (rendisni):

13. Jepni arsyet për ta bërë të qartë dëmin që i është shkaktuar sigurisë, shëndetit apo mirëqë nies së viktimës.

14. Prova (rendisni këtu prova mbështetëse dhe bashkëngjitjani dokumentet përkatës kësaj kërkese)

Numri i çështjes në polici:

Kopje e relacionit të policisë

Relacioni mjekësor

Akti i ekspertizës mjeko ligjore

Certifikata nga ofruesit e shërbimeve në fushën e dhunës në familje (rendis ni):

Vlerësimi i ekspertëve (rendisni): (p.sh., psikologu, specialisti i kafshëve shtëpiake e tj.)

Deklaratat e dëshmitarëve (rendisni):

Prova të tjera (rendisni): (p.sh., ditari i viktimës, vizatime të fëmijëve, fotografi të dëmtimeve, komunikimi me postë elektronike, SMS, regjistrime në kaseta etj.)

15. Paditësi i kërkon gjykatës të lëshojë urdhër mbrojtjeje për personat e mëposhtëm:

Emri	**Data e lindjes**	**Marrëdhënia me të padituri/ën**

16. Paditësi/paditësja i kërkon gjykatës që në urdhrin e saj të mbrojtjes të lëshojë masat e më poshtme: (nëse janë të zbatueshme, mund të zgjidhni më shumë se një alternativë)

I padituri/e paditura të mos kryejë vepër të dhunës në familje ndaj personave të për mendur më sipër

I padituri/e paditura të mos kërcënojë personat e përmendur më sipër

I padituri/e paditura të mos cenojë, ngacmojë apo kontaktojë me personat e përmendur më sipër

I padituri/e paditura të largohet nga banesa (adresa)

për një kohë prej (shënoni kohën) dhe të mos lejohet të rihyjë pa autorizimin e gjykatës

I padituri/e paditura të mos u afrohet personave të përmendur më sipër përtej një distance prej (shënoni distancën)

I padituri/e paditura të mos shkojë në:

- shkollën e (emri): , (adresa)
- kopshtin e (emri): , (adresa)
- vendin e punës së (emri): , (adresa)
- banesën e (emri): , (adresa)

Të vendosë personat e mëposhtëm në: (strehëz/banesë e përkohëshme) nën përgjegjësinë e (emri i organizatës /autoritetit)

I padituri/e paditura të kontaktojë (emri i fëmijës) vetëm (kur, dita e javës, afatet kohorë) në (vendin)
ose më anë të (mënyrat e kontaktimit)

Të ndalojë hyrjen dhe ndënjen e të paditurit/ padituresë në banesën e (emri) në (adresën)

Tëautorizojë(pozicioni/autoriteti) qëtëshoqërojë(cilin)
në banesën e viktimës dhe të shoqërojë lëvizjen e sendeve të tyre personale

I padituri/e paditura të dorëzojë të gjitha armët në (emri i institucionit/oficerit)

I padituri/e paditura të lejojë paditësin/paditësen të zotërojë banesën e përbashkët në adresën:

I padituri/e paditura t'i paguajë (emri i personit) sasinë mujore prej
për pagesën e qirasë

I padituri/e paditura t'i paguajë (emri i personit) sasinë mujore prej
si detyrim për të mbështetur personat e përmendur më sipër

I padituri/e paditura të mos lejohet të asgjësojë pasurinë bashkëshortore

Të paditurit/padituresë t'i hiqet përgjegjësia mbi fëmijët e tyre (emrat):

T'i jepet paditësit/sespërkohësisht e drejta e kujdestarisë mbi fëmijët (emrat)

Të urdhërohen shërbimet sociale (emrat) që t'u sigurojnë shërbimet e më poshtëme përsonave të sipërpërmendur (rendisni shërbimet që do viktima)

Të urdhërohet punëdhënësi i të paditurit/ës (emri i punëdhënësit)
që t'i paguajë personit (emri i personit) sasinë prej

Futja e viktimës në programe rehabilituese

Të urdhërohët dhunuesi/ja të marrë pjesë në programe rehabilitimi dhe këto programe të urdhërohen të raportojnë çdo javë në gjykatë nëse dhunuesi/ja e ndjek apo merr pjesë në të.

17. Kohëzgjatja e urdhrit mbrojtës

Emri i Paditësit: **Data:**

Nënshkrimi i paditësit:

Emri i përfaqësuesit:
(nëse ka)

Nënshkrimi i përfaqësuesit:

SHTOJCA D

KËRKESË-PADI
PËR LËSHIMIN E URDHRIT TË MENJËHERSHËM MBROJTËS

1. DREJTUAR GJYKATËS SË RRETHITGJYQËSOR

(Emri dhe adresa e gjykatës së rrethit)

Nr. i KËRKESË-PADISË / ÇËSHTJES:

2. **PADITËSI/JA**[1] **Vs.** **3. I/E PADITURI/A**

(Emri, atësia, mbiemri)

(Adresa e përhershme/e përkohshme e banimit)

Numër telefoni:

Përfaqësuar nga:

(Emri i përfaqësuesit ligjor ose përfaqësuesve të tjerë, nëse ka të tjerë)

(Adresa e përfaqësuesit)

Numër telefoni:

(Emri, atësia, mbiemri)

Adresa e përhershme e banimit:

Numër telefoni:

Adresa e përkohshme e banimit:

Numër telefoni:

4. Shënoni emrin dhe adresën e viktimës/ave nëse është i ndryshëm nga emri i paditësit (emri, atësia, mbiemri)

5. SHËNIM: Nëse duke dhënë adresën keni frikë për sigurinë tuaj apo të njerëzve të tjerë nën përgjegjësinë tuaj, ju lutem jepni më poshtë një adresë tjetër, të cilën dëshironi ta përdorni për qëllime të procesit gjyqësor:

Adresa:
Numri i telefonit:
Të dhëna të tjera kontakti:

6. Objekti i kërkesë padisë: Lëshimi i urdhrit të menjëhershëm mbrojtjes.

7. Kuadri ligjor: Ligji nr. 9669, datë 18 dhjetor 2006, "Për masa ndaj dhunës në marrë dhëniet familjare".

Skicimi i formularit © Këshilli i Evropës 2007. Përdorimi i këtij formulari nuk tregon mbështetjen e Këshillit të Evropës lidhur me çështjen ose argumentet e shprehura.

1 Paditësi mund të jetë viktima ose personat e tjerë të cilët autorizohen nga viktima të kërkojnë një urd hër të menjëhershëm mbrojtje, siç parashikohet nga neni 13, pika 3 i ligjit nr.9669, datë 18 dhjetor 2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". Këta përsona mund të jenë përfaqësuesi ligjor i viktimës ose punonjësi i policisë/prokurori apo në rast se viktima është i/e mitur, të afërmit e të miturit/ës, përfaqësuesi i i zyrës së shërbimeve sociale ose qendrat e licensuara për mbrojtjen e viktimave.

8. Shpjegoni marrëdhënien e viktimës me të paditurin/ën (sipas shënimit të mëposhtëm):
Viktima është i/e të paditurit/ës.

SHËNIM: Pjesëtarët e familjes janë (a) Bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja; apo ish bash këshorti/ja apo ish partneri/ja bashkëjetues; (b) Vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përf shirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar; (c) Bashkëshortët e personave të mësipërm; (d) Gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es; (e) Vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 (tre) muajve të fundit; (f) Fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues.

9. Të dhëna të mëtejshme për viktimën:

Data e lindjes	
Vendi i lindjes	
Gjendja civile	
Numri i fëmijëve	
Sa fëmijë me të paditurin/ën?	
Profesioni	
Punësimi	
Nënshtetësia	

10. Të dhëna të mëtejshme për të paditurin/ën:

Data e lindjes	
Vendi i lindjes	
Gjendja civile	
Numri i fëmijëve	
Profesioni	
Punësimi	
Adresa e punëdhënësit	
Nënshtetësia	
Zotëron apo disponon armët e mëposhtme	
Ka pronësi në banesën e përbashkët?	

11. Procese të tjerë ku janë të përfshirë viktima apo fëmijët e tyre dhe i/e padituri/paditura:

Emri i çështjes	Numri i çështjes	Gjykata kompetente

12. Faktet dhe rrethanat. Shpjegoni në mënyrë të qartë e të kujdesshme faktet dhe rrethanat e incidenteve të dhunës në marrëdhëniet familjare midis viktimës dhe të paditurit/ës (nëse është e nevojshme shtoni fletë të tjera):

Incidenti nr. 1
Data:
Vendi i Incidentit:
Veprimi apo mosveprimi :
Kundër kujt (rendisni):
Efektet mbi viktimën/viktimat(rendisni):
Përshkrim i mëtejshëm i incidentit:

Njërëz të pranishëm gjatë incidentit (rendisni):

Incidenti nr. 2
Data:
Vendi i Incidentit:
Veprimi apo mosveprimi :
Kundër kujt (rendisni):
Efektet mbi viktimën/viktimat(rendisni):
Përshkrim i mëtejshëm i incidentit:

Njërëz të pranishëm gjatë incidentit (rendisni):

Incidenti nr. 3
Data:
Vendi i Incidentit:
Veprimi apo mosveprimi :
Kundër kujt (rendisni):
Efektet mbi viktimën/viktimat(rendisni):
Përshkrim i mëtejshëm i incidentit:

Njërëz të pranishëm gjatë incidentit (rendisni):

13. Jepni arsyet për ta bërë të qartë dëmin që i është shkaktuar sigurisë, shëndetit apo mirëqë nies së viktimës:

14. Prova (rendisni këtu prova mbështetëse dhe bashkëngjitjani dokumentet përkatëse kësaj kërkese)

Numri i çështjes në polici:
Kopje e relacionit të policisë
Relacioni mjekësor
Akti i ekspertizës mjeko ligjore
Certifikata nga ofruesit e shërbimeve në fushën e dhunës në familje (rendisni):

Vlerësimi i ekspertëve (rendisni): (p.sh., psikologu, specialisti i kafshëve shtëpiake etj.)

Deklaratat e dëshmitarëve (rendisni):

Prova të tjera (rendisni): (p.sh., ditari i viktimës, vizatime të fëmijëve, fotografi të dëmtimeve, komunikimi me postë elektronike, SMS, regjistrime në kaseta, etj.).

15. Paditësi i kërkon gjykatës të lëshojë urdhër mbrojtjeje për personat e mëposhtëm:

Emri	**Data e lindjes**	**Marrëdhënia me të padituri/ën**

16. Paditësi/paditësja i kërkon gjykatës që në urdhrin e saj të menjëhershëm të mbrojtjes të lëshojë masat e mëposhtme (nëse janë të zbatueshme, mund të zgjidhni më shumë se një alterna tivë):

I padituri/e paditura të mos kryejë vepër të dhunës në familje ndaj personave të për mendur më sipër.

I padituri/e paditura të mos kërcënojë personat e përmendur më sipër.

I padituri/e paditura të mos cenojë, ngacmojë apo kontaktojë me personat e përmendur më sipër.

I padituri/e paditura të largohet nga banesa (adresa) për një kohë prej (shënoni kohën) dhe të mos lejohet të rihyjë pa autorizimin e gjykatës.

I padituri/e paditura të mos u afrohet personave të përmendur më sipër përtej një distance prej (shënoni distancën).

I padituri/e paditura të mos shkojë në:

- shkollën e (emri): , (adresa)
- kopshtin e (emri): , (adresa)
- vendin e punës së (emri): , (adresa)
- banesën e (emri): , (adresa) .

Të vendosë personat e mëposhtëm në: (strehëz/banesë e përkohëshme) nën përgjegjësinë e (emri i organizatës /autoritetit) .

I padituri/e paditura të kontaktojë (emri i fëmijës) vetëm (kur, dita e javës, afatet kohorë) në (vendin) ose me anë të (mënyrat e kontaktimit) .

Të ndalojë hyrjen dhe ndënjen e të padituri/ padituës në banesën e (emri) në (adresën) .

Tëautorizojë(pozicioni/autoriteti) qëtëshoqërojë(cilin) në banesën e viktimës dhe të shoqërojë lëvizjen e sendeve të tyre personale.

I padituri/e paditura të dorëzojë të gjitha armët në (emri i institucionit/oficerit).

17. Kohëzgjatja e urdhrit të menjëhershëm mbrojtës

Emri i Paditësit: **Data:**

Nënshkrimi i paditësit:

Emri i përfaqësuesit:
(nëse ka)

Nënshkrimi i përfaqësuesit:

SHTOJCA E

KËRKESË
PËR NDRYSHIMIN E NJË URDHRI MBROJTJEJE

1. DREJTUAR GJYKATËS SË RRETHITGJYQËSOR

(Emri dhe adresa e gjykatës së rrethit)

Nr. i KËRKESË-PADISË / ÇËSHTJES:

2. PADITËSI/JA[1] **Vs.** **3. I/E PADITURI/A**

2. PADITËSI/JA[1]	3. I/E PADITURI/A
_____ (Emri, atësia, mbiemri)	_____ (Emri, atësia, mbiemri)
_____ (Adresa e përhershme/e përkohshme e banimit)	_____ Adresa e përhershme e banimit:
_____ Numër telefoni: _____	_____ Numër telefoni: _____
Përfaqësuar nga:	_____ Adresa e përkohshme e banimit:
_____ (Emri i përfaqësuesit ligjor ose përfaqësuesve të tjerë, nëse ka të tjerë)	_____ Numër telefoni: _____
_____ (Adresa e përfaqësuesit)	
_____ Numër telefoni: _____	

4. Shënoni emrin dhe adresën e viktimës/ave nëse është i ndryshëm nga emri i paditësit (emri, atësia, mbiemri)

5. SHËNIM: Nëse duke dhënë adresën keni frikë për sigurinë tuaj apo të njerëzve të tjerë nën përgjegjësinë tuaj, ju lutem jepni më poshtë një adresë tjetër të cilën dëshironi ta përdorni për qëllime të procesit gjyqësor:

Adresa:
Numri i telefonit:
Të dhëna të tjera kontakti:

6. Objekti i kërkesë padisë: Ndryshimi i urdhrit të mbrojtjes.

7. Kuadri ligjor: Ligji nr. 9669, datë 18 dhjetor 2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

Skicimi i formularit © Këshilli i Evropës 2007. Përdorimi i këtij formulari nuk tregon mbështetjen e Këshillit të Evropës lidhur me çështjen ose argumentet e shprehura.

1 Paditësi mund të jetë viktima, përfaqësuesi lighor i tij/saj, dhunuesi ose prokurori nëse ka marrë pjesë në proces. Shih nenin 22, pika 1 të ligjit nr. 9669, datë 18 dhjetor 2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

8. Gjykata ka lëshuar më parë shënoni me kryq dhe plotësoni urdhrin përkatës më poshtë):
Një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, me vendimin nr. , datë
Një urdhër mbrojtjeje, me vendimin nr. , datë

9. Urdhrit të mësipërm i mbaron afati më:

10. Paditësi/ja kërkon që gjykata të ndryshojë urdhrin e treguar më sipër sepse ka një ndryshim të rëndësishëm të rrethanave të viktimës/paditësit/ses. Ajo që ka ndryshuar si më poshtë (jepni një përshkrim):

11. Për shkak të ndryshimit të rrethanave siç u përshkruan më sipër, paditësi/ja i kërkon gjykatës të ndryshojë urdhrin e saj të mëparshëm në elementët e mëposhtëm. (Rrethoni dhe plotësoni elementin përkatës. Nëse është e nevojshme mund të shtoni elementë të tjerë):

a. Subjektet të cilët mbron, duke shtuar/hequr (emri i personit) , data e lindjes , marrëdhënia me të paditurin/padituren në listë
b. Masat mbrojtëse, duke ndryshuar sasinë e detyrimeve mbështetëse në shifrën prej (shkruani shifrën) në muaj
c. Kohëzgjatja e urdhrit mbrojtës të shtrihet deri më datë
d. Të tjera (përcaktoni):

12. Prova (rendisni këtu prova mbështetëse dhe bashkëngjitjani dokumentet përkatës kësaj kërkese)
Numri i çështjes në polici:
Kopje e relacionit të policisë
Relacioni mjekësor
Akti i ekspertizës mjeko ligjore
Certifikata nga ofruesit e shërbimeve në fushën e dhunës në familje (rendisni):
Vlerësimi i ekspertëve (rendisni): (p sh., psikologu, specialisti i kafshëve shtëpiake etj.)

Deklaratat e dëshmitarëve (rendisni):
Prova të tjera (rendisni): (p.sh., ditari i viktimës, vizatime të fëmijëve, fotografi të dëmtimeve, komunikimi me postë elektronike, SMS, regjistrime në kaseta etj.)

Emri i paditësit/es: **Data:**

Nënshkrimi i paditësit:

Emri i përfaqësuesit:
(nëse ka)

Nënshkrimi i përfaqësuesit:

SHTOJCA F

RROTA E PUSHTETIT DHE KONTROLLIT



SHTOJCA G

LLOJET E ABUZIMIT BASHKËSHORTOR

ABUZIM FIZIK	ABUZIM SEKSUAL	ABUZIM PSIKOLOGJIK	ABUZIM SOCIAL
• KËRCËNIME - Për të përdorur armë, thikë, etj. - Për të vrarë - "Nuk do të ikësh dot kurrë nga unë" • VEPRIME - Shtyrje - Mbajtje poshtë - Goditje me shuplakë - Goditje me grusht - Mbytje - Rrahje - Kafshim - Pështyrje - Goditje me objekte, si abazhurë, telefona, etj. - Goditje e synuar - në gjoks, organ gjenitale të një gruaje shtatzënë - Gjuajtje me armë zjarri • LËNDIME TË SHKAKTUARA - Plagë - Sy të nxirë - Prerje/gërvishtje - Plagë të brendshme - Kocka të thyera	• E prek partnerin në mënyrë të tillë që e bën të ndihet në siklet • E trajton partnerin si një objekt seksual pa u kujdesur për ndjenjat apo dëshirat e tij • Pret kryerjen e marrëdhënies seksuale, si të jetë një detyrim • Refuzon seksin me të si formë ndëshkimi • Është qëllimisht i shthurur • Kryen marrëdhënie seksuale pasi ka përdorur dhunë: "Të lutem më fal!". • Akuzon partneren se është një lavire nëse i pëlqen seksi, sadizmi, etj. • Poshtëron partneren, duke e shitur atë tek miqtë, duke e lidhur, etj. • Kryen incest me fëmijët e partneres • Përdor dhunë në seks: goditje, mbytje, rrahje, para ose gjatë seksit • E rreh partneren pas intimitetit seksual • Nuk e lejon partnerin që të ketë kontroll mbi trupin dhe hapësirën e vet	• FYERJE - Përdor shaka poshtëruese - Përdor terma ulës - E thërret partneren budallaqe, e paaftë, e shëmtuar - E etiketon partneren me fjalët: e çmendur, bushtër, lavire. • KANOSJE - Për të shkatërruar pronën - Për të marrë fëmijët nëse partneri tenton të divorcohet - Për të kryer vetëvrasje • IZOLIM - E ndan personin nga familjarët dhe miqtë - E pengon personin të marrë makinën e tij/saj - I kontrollon telefonin - Verifikon ku ndodhet ai/ajo • FAJËSIM - Fajëson tjetrin për dhunën - Lëndon fëmijët dhe fajëson partnerin - E poshtëron - Djeg sendet vetjake të partnerit - Lëndon ose vret kafshët shtëpiake	• Shoqëria përforcon rolin e grave/burrave • Shoqëria inkurajon diskriminimin gjinor përmes shakave seksuale, batutave ironike, komenteve të sikletshme • Familja, miqtë, kolegët ndihmojnë në izolimin e grave • Të tjerët e fajësojnë viktimën duke e quajtur atë madje bushtër, e çmendur, lavire, mazokiste, viktimë e përhershme, gënjeshtare, histerike, ekzagjeruese • Ligji përforcon varësinë e një gruaje ndaj burrit • Izolimi inkurajohet kur: -Policia injoron të dhënat -Mjekët pranojnë të besojnë gënjeshtrat ose thonë se dhuna në familje është çështje private -Shoqëria fajëson nënat për problemet në familje

SHTOJCA H

DITARI I VIKTIMËS MBI ABUZIMIN DHE NGACMIMIN

Çfarë ndodhi:

Lloji i ngacmimit:

☐ Telefon ☐ Letër ☐ Personalisht ☐ Tjetër

Ku ka ndodhur ngacmimi?

Adresa:

Data: Ora:

Dëshmitarët:

Emri:
1)
2)

Numri i telefonit:
1)
2)

Adresa:
1)
2)

Kontakti me policinë:

Emri dhe numri i identifikimit i punonjësit të policisë: Data: Ora:

Numri i raportit policor: Si u kontaktua policia?:

Provat e mbledhura:

☐ fotografi të plagëve ☐ fotografi të rrëmujës në shtëpi

☐ kopje të të gjitha letrave ☐ mesazhe në sekretarinë telefonike

Ky formular është marrë nga botimi i Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara, Zyra e Avokatit të Shteteve të Bashkuara, Rrethi i Kolumbisë, Njësia për asistencë ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, *Të Kuptojmë Dhunën në Familje: Një Manual për Viktimat dhe Profesionistët.*

SHTOJCA I

LISTË E GJËRAVE QË DUHET TË MERRNI ME VETE NËSE LARGOHENI NGA SHTËPIA

(Është e këshillueshme që dokumentet origjinale ose kopjet t'ia lini një miku/të afërmi/fqinji në mënyrë që kur të largoheni nga banesa të mos shqetësoheni për të mbledhur dokumentet)

- Lejen për drejtim automjeti, lejen e qarkullimit, dhe dokumente të tjera identifikimi me fotografi;
- Urdhrat e mbrojtjes dhe dokumentet e tjera gjyqësore;
- Numëratorin telefonik me të gjitha numrat e rëndësishëm;
- Të dhënat e punonjësit të policisë (adresa, telefoni) me të cilin jeni lidhur për indicente të ngjashme që ju kanë ndodhur më parë;
- Certifikatat e lindjes tuajën dhe të fëmijës;
- Paratë, kartat e debitit dhe kartat e kreditit;
- Kontratën e qirasë, hipotekën e shtëpisë;
- Regjistrin bankar dhe blloqet e çeqeve;
- Dokumentet e asistencës sociale;
- Çelësat e shtëpisë, punës dhe makinës;
- Ilaçet për veten dhe fëmijën;
- Kartelat mjekësore;
- Dokumentet e sigurimeve shoqërore, tuajat dhe të fëmijës;
- Dëftesat shkolle dhe ato të vaksinimit;
- Lejen e punësimit;
- Pasaportën tuajën dhe të fëmijës;
- Dokumentet e divorcit;
- Bizhuteritë;
- Lodrat e fëmijëve.

Numra të rëndësishëm telefoni

- Komisariati i policisë
- Punonjësi i policisë me të cilin keni punuar ngushtë
- Streha për gratë e dhunuara
- OJF ja (nëse një e tillë ju ka asistuar më parë)
- Prokurori (nëse është bërë një kallëzim penal ndaj dhunuesit)
- Prifti
- Tjetër

Kjo listë është marrë nga botimi i Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara, Zyra e Avokatit të Shteteve të Bashkuara, Rrethi i Kolumbisë, Njësia për asistencë ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, *Të Kuptojmë Dhunën në Familje: Një Manual për Viktimat dhe Profesionistët.*